



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TE JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Gjuhë Angleze”

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Eriona ÇELA

Dr. Rudina VRIONI

Maj /2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në “Gjuhë Angleze”


1	IAL aplikues:	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhëve të Huaja
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjuhë angleze”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr 300, datë 21.06.1994
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 334, dt.13.07.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Studime me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit, për vitin akademik 2022-2023	15 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 6 studentë; 2021-2022 5 studentë; 2022-2023 14 studentë.
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër (UGJ) është një Institucion Publik i Arsimit të Lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 414, datë 12.11.1991, “Për hapjen e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër. UGJ është ngritur mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik të krijuar në vitin 1971. Në vitin akademik 1993-1994, me Vendim të Këshillit të Ministrave përkatësisht Nr. 300, datë 21.06.1994, Universiteti i Gjirokastrës u zgjerua me hapjen e degës së Gjuhës e Letërsisë Angleze. Nga viti 1994 e në vazhdim, Universiteti “Eqrem Çabej” filloi funksionimin mbi bazën e departamenteve. Universiteti “Eqrem Çabej” është akredituar në nivel institucional, për herë të parë me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 67, datë 21.09.2017 “Për akreditimin e parë të Institucionit të Arsimit të Lartë, të Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër dhe riakredituar me vendimin Nr. 55, datë 16.12.2021 për “Akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë të Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër”. Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, përbëhet nga 3 fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Natyrore;
2. Fakulteti i Ekonomisë;
3. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;

Programi Bachelor në “Gjuhë angleze” ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Departamenti i Gjuhëve të Huaja është përgjegjës për 3 programe studimi: një program i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Gjuhë angleze”, një program i ciklit të dytë të studimit Master në “Mësuesi në gjuhë angleze” dhe një program i ciklit të dytë të studimit Master në “Mësuesi në gjuhë italiane”. Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” me kohëzgjatje 3-vjeçare u hap për herë të parë në vitin akademik 2010-2011, me Vendim të Departamentit të Gjuhëve të Huaja dt. 05. 10. 2010. Ky program studimi në vite ka pësuar ndryshime në funksion të ndryshimeve ligjore dhe kërkesave të tregut të punës. Ai është hartuar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, ligjin 80/2015 “Per arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, datë 22.07.2015., VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018”, VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018” etj, Statutin e UGJ-së dhe rregulloret institucionale. Nga viti 1994, kur është hapur për herë të parë dega Gjuhë Angleze e deri në vitin akademik 2022-2023, janë diplomuar 668 studentë. Programi përputhet me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë bazë që i formojnë ata si profesionistë të gjuhës angleze. Kurrikula e programit është e strukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve në 180 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në tre vite akademike. Në programin në fjalë janë regjistruar 11 studentë në vitin akademik 2023-2024. Për realizimin e programit njësia ka angazhuar aktualisht 12 Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 3 personel akademik me kontratë (PAK). Qëllimi kryesor i programit është të përgatisë studentë të aftë për t’ju përgjigjur kërkesave të reja të tregut dhe zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në vend, duke i pajisur studentët me njohuri të qëndrueshme në fushën e gjuhës angleze. Njësia ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të tjera në kuadër të mobiliteteve staf dhe studentë të këtij programi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë angleze”. Bazuar në Urdhër Nr.119, Datë 28.09.2023, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) ka në përbërje: Dr Eriona Çela dhe Dr. Rudina Vrioni. Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Anilda Beqiraj.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), i hartuar në Shtator 2023 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, për të përmbushur synimet si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm është i shoqëruar nga një dosje prej 271 evidencash, që mbështesin kuadrin ligjor, menaxhimin institucional dhe administrimin e këtij programi, në lidhje me rregulloret dhe planet strategjike të zhvillimit, stafin akademik dhe studentët, objektivat e programet dhe rezultatet e të nxëniet, aktorët mbështetës, sigurimin e cilësisë dhe administrimin financiar dhe infrastrukturor në dispozicion të tij. Shkrimi i RVB reflekton profesionalizëm, kujdes në analizën e përmbushjes së standardeve dhe vëmendje në pasqyrimin konkret të gjetjeve në pjesën përshkruese. GVB reflektoi gjithashtu njohje të sa më sipër edhe gjatë intervistës me GVJ. Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 20 dhe 21 Nëntor 2023, GVJ organizoi takime me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik dhe studentët, stafin administrativ në shërbim të studentëve, përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike dhe Administrative, Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave, Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me jashtë, përfaqësues të Sektorit të Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore dhe Studentore. GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit të procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorin, sallat e Internetit, etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Pas vizitës në institucion, GVJ krijoi ide më të qarta në lidhje me përgjegjësitë, procedurat, organizimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe burimeve njerëzore në dispozicion të tij. Takimet u shoqëruan me diskutime të shumta dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.



Më datë 13/05/2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 85/14Prot. datë 13/05/2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Universiteti ktheu përgjigje përmes AMS, më datë 20/05/2024, me shkresë zyrtare Nr. 735/1Prot., datë 20/05/2024. Komentet nuk ka, Drafti kalon në Raport përfundimtar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë angleze”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” ofrohet në përputhje me përcaktimet e Statutit dhe të Planit Strategjik të Universitetit, si dhe me misionin e Departamentit të Gjuhëve të Huaja (DGJH), si njësi përbërëse të tij. Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por kontribuon direkt në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e vendit. Evidenca <i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Neni 2, Neni 8;</i> <i>Evidenca 5 Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025, Misioni, fq 8, Vizioni q 8;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se misioni dhe objektivat e këtij programi studimi janë të tilla që mundësojnë hedhjen e bazave shkencore dhe përgatitjen e nevojshme për formimin e studentëve. Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” plotëson kriteret në hartimin e tij dhe ofrohet në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe fushën e veprimtarisë së tij. Ky program studimi synon të ofrojë një formim bazë në disipinat e Gjuhësisë dhe Letërsisë angleze, duke i ndihmuar studentët në aspektin e punësimit dhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në programe të tjera përkatëse integruese. Evidenca

	<p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Nenet 4, 5, 8; Neni 8, pika 5;</i></p> <p><i>Evidenca 5 Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025, Misioni, fq 8, Vizioni fq 8;</i></p> <p><i>Evidenca I.6 Strategji zhvillimi Njësia Kryesore FESHSH, Vizioni fq 9, Misioni, fq 9;</i></p> <p><i>Evidenca I.8 Plani strategjik i Njesisë Bazë të Gjuhëve të Huaja;</i></p>																					
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Gjuhë angleze" ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë së zhvillimit të UGJ, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit. Ky program, studimi synon të përgatisë specialistë të gjuhës angleze, për t'iu përgjigjur nevojave kombëtare e rajonale në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në zhvillim.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca 5 Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025, Misioni, fq 8, Vizioni fq 8;</i></p> <p><i>Evidenca I,1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Nenet 62, 63, 65;</i></p> <p><i>Evidenca 2 Rregullore e UGJ-së, Nenet 42, 46, 48;</i></p>																					
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Referuar DVV, GVJ konstaton që Universiteti "Eqrem Çabej" ka burimet, kapacitetet dhe përvijën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në "Gjuhë angleze". UGJ-ja është një institucion i arsimit të lartë i kategorisë Universitet, themeluar në 1971. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në vitin akademik 2022-2023, referuar (<i>Evidenca 41 ANEKSET ASCAL per RVB, tab 1</i>) ka 92 staf akademik gjithsej, ku 62 janë pedagogë me kohë të plotë, dhe 30 pedagogë me kohë të pjesshme, me kualifikimin si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>5</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Prof. As. Dr.</td> <td>12</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Dr. / PhD.</td> <td>17</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>MSc.</td> <td>28</td> <td>17</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>62</td> <td>30</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td colspan="2">92</td> </tr> </tbody> </table>	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	PAE	PAK	Prof. Dr.	5	6	Prof. As. Dr.	12	3	Dr. / PhD.	17	4	MSc.	28	17	Në total	62	30	Totali	92	
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore	PAE	PAK																				
Prof. Dr.	5	6																				
Prof. As. Dr.	12	3																				
Dr. / PhD.	17	4																				
MSc.	28	17																				
Në total	62	30																				
Totali	92																					

Ndërsa Departamenti i Gjuhëve të Huaja si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit ka në përbërje të tij në vitin akademik 2022-2023 staf akademik si më poshtë:

Departamenti i Gjuhëve të Huaja	PAE	PAK
Prof. Dr.	-	-
Prof. As. Dr.	4	-
Dr. / PhD.	3	2
MSc.	5	1
Në total	12	3

Në këtë program në këtë vit akademik janë angazhuar 15 Personel Akademik Efektiv (PAE), dhe 1 Personel Akademik me Kontratë (PAK). Staf i akademik, bazuar në CV-të rezulton me përvojë dhe i përshtatshëm për disipinat specifike të këtij programi studimi. Nga të dhënat që jepen në DVV, stafi akademik ka kualifikimin e duhur për formimin në përputhje me fushat akademike dhe kërkimore që përfshin programi si dhe angazhimi i tyre akademik është në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës.

Evidenca

Evidenca I.18 Vendimi i hapjes së ILP-së;

Evidenca I.18.1 Vendimi mbi krijimin e Universitetit "Eqrem Çabej";

Evidenca I.21 Vendim i Akreditimit Institucional periodik.

Evidenca 41 ANEKSET ASCAL per RVB, tab 1, 2,6;

Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe

GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë angleze" (shih RVB) është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore si dhe atë të Njesisë bazë.

Ky program studimi është hartuar në përputhje me Strategjitë Kombëtare të Zhvillimit. Programi është krijuar për të plotësuar nevojat e tregut për specialistë në fushën e gjuhës angleze. DGJH bazuar në nenin 86 të ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.5.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit

<p>udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>të Lartë në Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave ka propozuar kodifikimin e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR).</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Nenet 5, 63;</i></p> <p><i>Evidenca I.6 Strategji zhvillimi Njësia Kryesore FESHSH, Vizioni fq 9, Misioni, fq 9, Prioritetet strategjike fq.10;</i></p> <p><i>Evidenca I.22 Përcjellja në MASR e propozimeve për kodifikimin e programeve;</i></p> <p><i>Evidenca I.22.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FESHSH.</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit, Bachelor në “Gjuhë Angleze” që ofrohet në Universitetin “Eqrem Çabej”, në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe aktivitetin e tij.</i></p> <p><i>Ky program, studimi synon të përgatisë specialistë të gjuhës angleze, për t’iu përgjigjur nevojave kombëtare e rajonale në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në zhvillim.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <th data-bbox="616 976 794 1066">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="794 976 995 1066">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="995 976 1197 1066">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1197 976 1394 1066">Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td data-bbox="616 1066 794 1120"></td> <td data-bbox="794 1066 995 1120"></td> <td data-bbox="995 1066 1197 1120"></td> <td data-bbox="1197 1066 1394 1120">X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi I.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së</p>	<p>GVJ lidhur me vlerësimin e këtij kriteri, mori në shqyrtim Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, Statutin dhe Rregulloren e UGJ, si dhe aktet rregullatore specifike. GVJ analizoi gjithashtu edhe përgjigjet e grupeve gjatë takimeve të organizuara në institucion dhe konstaton se UGJ siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit, kjo sipas detyrave të përcaktuara qartë si ndërmjet strukturave përbërëse të UGJ ashtu dhe roleve të përcaktuara sipas strukturës.</p> <p>Krahas Rregullosës së Njësive kryesore, Njësia bazë ka rregulloren e saj dhe Rregulloren e Programit të Studimit, në të cilat janë të përcaktuara qartë roli dhe detyra e drejtuesit të</p>

<p>vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Njesisë bazë, përgjegjësit të grupit për çdo grup-lënde, koordinatorit të programit, koordinatorit shkencor, lektorëve etj. DGJH për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit mes Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Fakultetit të Ekonomisë, si dhe brenda Njesisë Kryesore me Departamentin e Gjuhës shqipe dhe të Letërsisë shqipe. Po ashtu, vërehet bashkëpunim me strukturat e institucionit (Sektori i Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore, Studentore; Sektori i Marrëdhënieve me jashtë dhe i kërkimit shkencor etj.)</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Kreu II, III, IV, dhe V; Rregullore e UGJ-së, Kreu II, III, IV dhe V;</i></p> <p><i>Evidenca I.16 Organigrama Departamenti i Gjuhëve të Huaja;</i></p> <p><i>Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca I.11.6 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca I.29 Tabela e angazhimit të personelit akademik DGJH për vitin akademik 2019-2020, lëndët dhe ngarkesa përkatëse;</i></p> <p><i>Evidenca I.29.1 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik DGJH për vitin akademik 2020-2021, lëndët dhe ngarkesa përkatëse;</i></p> <p><i>Evidenca I.29.2 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik DGJH për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga takimi me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe me përfaqësuesin e Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, u konstatua se në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor institucioni ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh me institucione arsimore vendase dhe të huaja. Këto marrëveshje sigurojnë bashkëpunimin me universitete të ndryshme në Bashkimin Evropian në kuadrin e programit Erasmus+, të cilat shoqërohen jo vetëm me mobilitetin e stafit akademik, por edhe të studentëve. Nëpërmjet marrëveshjeve, sigurohen marrëdhënie bashkëpunimi ku përfitues janë studentët dhe personeli akademik. Aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, pasqyrohen edhe në raportet vjetore institucionale.</p> <p>Evidenca</p>

	<p><i>Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025, Lidhjet komunitare dhe kombëtare fq.31, Roli Ndërkombëtar fq. 32;</i></p> <p><i>Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca I.11.6 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Gjuhë Angleze”, nuk parashikon në planin mësimor lëndën “Praktikë profesionale”. Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi, por ato nuk përdoren zyrtarisht për zhvillimin e praktikave, pasi praktikat nuk janë të parashikuara në planin mësimor.</p> <p><u>Sugjerohet</u> që institucioni të shtojë në planin mësimor lëndën e “Praktikës profesionale” dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të shfrytëzohen në kuadër të kryerjes së praktikave profesionale, të institucionalizuara dhe t’i shërbejnë studentëve të këtij programi studimi me qëllim afrimin e tyre në tregun e punës.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në fund të vitit akademik, njësia bazë realizon analizën e punës mësimore dhe shkencore ku përveç aspekteve të tjera të punës që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e këtij programi studimi, shqyrton dhe analizon marrëveshjet e bashkëpunimit. Departamenti harton raporte analitike në mënyrë të vazhdueshme mbi rezultatet dhe përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit, në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi Bachelor në “Gjuhë angleze” në planin mësimor nuk përmban zhvillim të praktikës së detyruar profesionale.</i></p> <p><u>Sugjerohet</u> që institucioni të shtojë në planin mësimor lëndën e “Praktikës profesionale” pasi zhvillimi i kësaj lënde i ndihmon studentët në zhvillimin e aftësive praktike dhe në konsolidimin e njohurive.</p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit të shfrytëzohen në kuadër të kryerjes së praktikave profesionale të institucionalizuara dhe t’i shërbejnë studentëve të këtij programi studimi me qëllim afrimin e tyre në tregun e punës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Gjuhë angleze”, është në përputhje të plotë me dispozitat e legjislacionit vendas në fuqi për arsimin e lartë. Ky program zbatohet në vijueshmëri me specifikimet e Rregullores së Programit të Studimit.</p> <p>Programi ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, dhe me kohë të plotë. Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” përmban 180 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar. Programi është i organizuar në lëndë dhe module të cilat pasqyrohen në Planin Mësimor, ku krahas tyre jepen edhe kreditet përkatëse sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) si dhe të dhëna të tjera mbi tipologjinë e lëndës, semestrin apo vitin akademik kur mund të frekuentohet, ngarkesën semestrale, etj. Në përfundim të këtij programi studimi, studentit i jepet diplomë Bachelor në “Gjuhë angleze”.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, neni 11, pika 1;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë angleze”, Kreu II;</i></p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor BA në Gjuhë angleze 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.3 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018;</i></p> <p><i>Evidenca II.3.1 VKM Nr. 879, Datë 18.12.2019;</i></p> <p><i>Evidenca II.3.2 VKM Nr. 185, datë 25.3.2021;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze, fq.14 (Diplomat dhe shtojcat e diplomave);</i></p>

	<p><i>Evidenca II.5 Model diplome Bachelor në Gjuhë angleze;</i> <i>Evidenca II.4 Regjistrim i formës së diplomës për Bachelor.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Qëllimi i programit të studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” është të ofrojë një formim bazë në fushën e gjuhës angleze, i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi në aspektin e punësimit, dhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në gjuhë angleze apo programe të tjera. Në përfundim të studimeve 3-vjeçare studentët pajisen me njohuritë dhe aftësitë bazë të zbatueshme në përputhje me formimin e tyre të përgjithshëm gjuhësor, letrar, historik dhe të qytetërimit anglishtfolës. Studentët aftësohen për të komunikuar dhe kaluar nga një gjuhë në tjetrën, në kontekste dhe fusha të ndryshme në një nivel të përparuar në gjuhën angleze si gjuhë B. Ata janë në gjendje të identifikojnë dhe korrigjojnë të metat (gjuhësore dhe / ose logjike) në tekstet e natyrave dhe stileve të ndryshme.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plani mësimor Bachelor në Gjuhë angleze 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuset) e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, por edhe në plan programet e lëndëve, vërehet se secila lëndë ka të përcaktuar objektivat formuese, ngarkesën e parashikuar për studentët në total kreditesh dhe orësh në auditor. Programi i studimit “Gjuhë angleze” mbështetet në bazën ligjore për sa i përket veprimtarive formuese, ku lëndët/modulet i gjejmë të grupuara sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Për programin e studimit në fjalë, kurrikula mësimore me disiplina dhe plani mësimor mbështetet në këto kategori:</p> <p>A. Lëndë bazë (32 kredite – 17.7%);</p> <p>B. Lëndë karakterizuese (96 kredite – 53.3%);</p> <p>C. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese (22 kredite – 12.2%);</p> <p>D. Lëndë Plotësuese (22 kredite – 12.2%);</p> <p>E. Detyrime Përmbyllëse (8 kredite – 4.4%);</p> <p>Kurrikula e këtij programi është hartuar duke mbajtur parasysh që çdo kurs të zërë vendin që i takon në kuadër të veprimtarive formuese mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi.</p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në rregulloret përkatëse, studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Gjuhë angleze diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome të cilat përfaqësojnë 8 kredite - 4.44% të numrit total të krediteve. Ky program studimi nuk ka të parashikuar lëndën e Praktikës profesionale.</p> <p><i>GVJ sugjeron institucionin, që të shtojë në planin mësimor lëndën e Praktikës profesionale duke e shoqëruar edhe me syllabusin përkatës, ku të përshkruhen së paku detyrimet e studentit për zhvillimin dhe vlerësimin e këtij aktiviteti formues.</i></p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ, Neni 93, pika 1;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Neni 39, pika 1, pika 2;</i></p> <p><i>Evidenca I.5.1 Vendimi i SA për miratimin e Rregullores së studimeve;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit në Gjuhë angleze, Kreu III, fq.7(prova finale);</i></p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor BA në Gjuhë angleze 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Dosja e programit të studimit “Gjuhë Angleze” përmban elementët e mëposhtëm: emërtimin e programit, objektivat formuese, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë përkatës, ngarkesën mësimore dhe organizimin e saj në ECTS (planin mësimor), kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, kuotat dhe kriteret e pranimit, kodin e etikës akademike, detyrimet përmbyllëse, diplomën dhe suplementin. Forma e organizimit të studimeve në programin e studimit Bachelor në Gjuhë angleze është: studime me kohë të plotë.</p> <p>Modelet e financimit të studentëve përfshijnë financimin nëpërmjet bursave dhe financimin nëpërmjet përjashtimit nga tarifat e studimit. Në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UGJ.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ, neni 49, neni 61, neni 65;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Neni 17;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë angleze, fq.15;</i></p> <p><i>Evidenca II.14 Vendimet e BA për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta;</i></p>



	<p><i>Evidenca II.14 Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca II.14 Lista e studentëve me aftësi të kufizuar;</i></p> <p><i>Evidenca II.14.3 Vendim Rektorati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë;</i></p> <p><i>Evidenca II.14.4 Vendim Senati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë;</i></p> <p><i>Evidenca II.14.5 Vendim i Bordit të Administrimit për heqjen e tarifës për programet e mësuesisë.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues të këtij raporti, të vëna në dispozicion nga UGJ dhe duke i krahasuar ato me programe të ngjashme studimi të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë në vend, vihet re se Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” në UGJ (referuar programeve të studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë në Universitetet Publike në Shqipëri), ka përmbajtje të ngjashme në masën deri 70 për qind. me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Universiteti i Tiranës; - Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë; - Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan; <p>https://fgjh.edu.al/bachelor-ne-gjuhe-anglezehttps://fgjh.edu.al/bachelor-ne-gjuhe-angleze</p> <p>https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/01/BA-ne-gjuhe-angleze-2017-18.</p> <p>https://uniel.ems.al/school/program/4a72ad5d-9ec7-4d17-b714-ace100c19921.aspx</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Përsa i përket kodifikimit të programeve/ klasifikimit, referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentacionit shoqërues si dhe VKM nr. 310, datë 11.05.2022 për “Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kodifikimi i këtij programi studimi është propozuar nga UGJ pritët aprovimi nga MASR për realizimin e tij.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.22 Percjellja në MASR e propozimeve për kodifikimin e programeve;</i></p> <p><i>Evidenca I.22.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FESHSH;</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve</p>	<p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti “Eqrem Çabej”, nuk ofron programe të përbashkëta me asnjë institucion të arsimit të lartë. Programi i studimit “Gjuhë Angleze” mbulohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja pranë këtij fakulteti.</p>

të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<p><i>Programi i Studimit Bachelor në "Gjuhë angleze" përmban objektivat formuese, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë përkatës, ngarkesën mësimore dhe organizimin e saj në ECTS, vlerësimin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, kuotat dhe kriteret e pranimit, kodin e etikës akademike, detyrimet përmbyllëse, diplomën dhe suplementin .</i></p> <p><i>Ky program studimi nuk parashikon lëndën e "Praktikës profesionale" që gjykojmë se është e nevojshme për një program të tillë studimit. <u>Sugjerojmë</u> institucionin, që të shtojë në planin mësimor lëndën e praktikës profesionale duke e shoqëruar edhe me syllabusin përkatës, ku të përshkruhen së paku detyrimet e studentit për zhvillimin dhe vlerësimin e këtij aktiviteti formues. Gjithashtu, në kuadrin e ndërkombëtarizimit, sugjerohet shtimi i përpjekjeve për realizimin e programeve të përbashkëta nëpërmjet bashkëpunimit me universitete të tjera si një mënyrë për të tërhequr më shumë studentë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 6 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti Histori-Gjeografi; 2. Departamenti i Gjuhëve të Huaja; 3. Departamenti i Gjuhës Shqipe; 4. Departamenti i Letërsisë Shqipe; 5. Departamenti i Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek; <p>Në përputhje edhe me tabelat në RVB për këtë program, shihet se departamentet e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore përmbushin kërkesat ligjore për numrin e stafit akademik efektiv, PAE (çdo njësi bazë duhet të ketë të paktën</p>

7 personel akademik të brendshëm, ndër të cilët 3 të jenë me tituj dhe grada). *I vetmi department që nuk përmbush këtë kriter është ai i Letërsisë Shqipe i cili, megjithatë nuk është njësi bazë që ofron programin e studimit.*

Tabelat më poshtë paraqesin përbërjen e stafit efektiv dhe me kontratë për njësinë kryesore, njësinë bazë:

Kualifikimi i stafit akademik të	Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore					
	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	6	4	5	6	5	6
Prof. Asoc.	10	3	12	5	12	3
Dr/Phd	18	5	18	5	17	4
Msc.	21	15	21	13	28	17
Gjithsej	55	27	56	29	62	30

Kualifikimi i stafit akademik të	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja					
	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	2	-	4	-	4	-
Dr/Phd	5	2	3	2	3	2
Msc.	4	3	5	1	5	1
Gjithsej	11	5	12	3	12	3

UGJ-ja ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL.

Evidenca

Evidenca I.19 Vendim për hapjen e njësisë kryesore FESHSH;

Evidenca I.5 Rregullore e Njësisë Kryesore FESHSH, Neni 5;

Evidenca I.17 Vendim riorganizimi i DGJH në grupe mësimore kërkimore të përbërë nga 5(pesë) dhe 6(gjashë) anëtarë personel akademik me kohë të plotë;

	<p><i>Evidenca I.21 Vendim i Akreditimit Institucional periodik</i></p> <p><i>Evidenca Statuti i UGJ, Neni 11;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Neni 5;</i></p> <p><i>Evidenca II.17 Lista e personelit akademik të Njesisë kryesore.</i></p> <p><i>Evidenca 41 ANEKSET ASCAL per RVB;</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi duke angazhuar 1(një) personel ndihmës akademik me karakter mësimor, për realizimin e punëve laboratorike deri më 26.11.2021.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.16 Organigrama Departamentit të Gjuhëve të Huaja;</i></p> <p><i>Evidenca I.27 Rregullore e punësimit të personelit akademik Nenet 7, 8, 9;</i></p> <p><i>Evidenca II.17 Lista e stafit akademik dhe ndihmës akademik FESHSH;</i></p> <p><i>Evidenca II.17.1 Lista e personelit akademik dhe ndihmës akademik, DGJH;</i></p> <p><i>Evidenca II.17.2 Urdhër i lirimit nga detyra e personelit ndihmës-akademik;</i></p> <p><i>Evidenca I.3 Ligji Nr. 80/2015 i Arsimit të Lartë, Neni 25, pika 4.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në takimet me stafin akademik, GVJ konstaton se Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në përputhje me objektivat për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, ka të përcaktuar rolin e koordinatorit të programit të studimit. Roli i koordinatorit për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” mbulohet nga dy përfaqësues të grupeve mësimore kërkimore të cilët ndjekin ecurinë dhe zhvillimin e programit sipas grup-lëndëve respektive që mbulojnë.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në Universitetin “Eqrem Çabej”, në tërësi, dhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja në veçanti, përmbushin kriteret organizative në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë.</i></p> <p><i>Departamenti i Gjuhëve të Huaja, si përgjegjës për programin e studimit bachelor në “Gjuhë Angleze” përmbush të gjitha</i></p>





	<i>detyrimet ligjore dhe nënljgore për organizimin dhe strukturën akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në FESHSH, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e ciklit të parë, Bachelor në “Gjuhë Angleze”, Departamenti i Gjuhëve të Huaja, disponon dhe ka vënë në dispozicion informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, është i strukturuar në 3 vite akademike të organizuara në 6 semestra.</p> <p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite. Në vitin e tretë është parashikuar punimi i diplomës ose provimi i formimit. Për çdo lëndë, në planin mësimor është parashikuar ngarkesa mësimore në auditor si ngarkesë totale dhe ajo jashtë tij. Programi mbështetet në planin mësimor i cili gjen zbatim nëpërmjet programeve lëndore përkatëse. Plani mësimor paraqet informacione që lidhen me ngarkesën mësimore, titullin e veprimtarisë formuese, kategorinë e veprimtarisë, frekuentimin, kreditet e lëndëve, orët mësimore në javë, semestrin kur mund të frekuentohet një lëndë e caktuar, numrin e orëve në auditor ose për studim individual. Plani mësimor është hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënljgore në fuqi.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.8 Plani mësimor Bachelor në Gjuhë angleze 2018-2019;</i></p>


	<p><i>Evidenca II.9.1 Plani mësimor Bachelor në Gjuhë angleze 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Njësia Bazë propozon për çdo vit kriteret specifike të pranimit bazuar në cilësinë dhe programet e maturantëve dhe nevojat e tregut për profilin Bachelor në “Gjuhë Angleze”. Institucioni, dhe në veçanti, njësia bazë propozon për çdo vit kriteret specifike të pranimit bazuar në cilësinë dhe programet e maturantëve dhe nevojat e tregut për profilin Bachelor në “Gjuhë Angleze”. Në rregulloren e njësisë kryesore dhe në atë të programit të studimit janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e tyre. Kriteret specifike dhe mënyrat e vlerësimit dhe njohjen e krediteve propozohen nga njësia bazë dhe janë pjesë e procedurës së ekuivalentimit të njohurive të mëparshme të studentit, kur ka kërkesa për transferime.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGj-së, Neni i 49, neni 61, neni 65;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Kreu VI;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Njësisë Kryesore FESHSH, Kreu IV;</i></p> <p><i>Evidenca II.10.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca II.10.2 Raporti i verifikimit të kapaciteteve pritëse 2021-2022; Vendim SA për kuotat 2020 -2021;</i></p> <p><i>Evidenca II.11.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2021-2022; Kriteret e pranimit të studentëve 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.13.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023;</i></p> <p><i>Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, janë paraqitur programet e lëndëve, të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E. Pjesë përbërëse e dosjes së programit të studimit “Gjuhë Angleze” janë edhe programet lëndore (syllabuset e detajuara), të cilat mbështesin planin mësimor të këtij programi studimi. Ato përmbajnë informacionin që i nevojitet studentëve mbi lëndët përkatëse. Këtu përfshihen: përmbledhja dhe rezultatet e të nxënies, objektivat e lëndës, konceptet themelore që do të trajtohen, kalendari javor me temat përkatëse, forma e kontrollit të dijeve si dhe literatura përkatëse, që është specifike për çdo lëndë. Gjatë takimeve me Drejtuesin e Njësisë Bazë dhe stafin akademik GVJ konstatoi se syllabuset hartohen nga pedagogët përgjegjës në fillim të semestrit dhe miratohen nga Drejtuesi i Njësisë Bazë, i cili merr</p>




	<p>miratimin e grupit mësimor dhe kërkimor-shkencor për syllabuset të cilat mbulohen nga ky grup. Syllabuset (programet lëndore) u prezantohen dhe shpjegohen studentëve në orën e parë të zhvillimit të kursit nga pedagogu përkatës. Gjatë kontrollit të DVV u vu re se syllabuset e lëndëve kanë mangësi në formatim dhe nuk janë të unifikuara sipas Shtojcës Nr. 2 të VKM . Nr 41.</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni të rishohë syllabuset e lëndëve duke arritur një unifikim në formatimin e programeve të lëndëve sipas Shtojcës Nr. 2 të VKM . Nr 41.</i></p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.3 VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë";</i></p> <p><i>Evidenca II.3.1 VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" ;</i></p> <p><i>Evidenca II.3.2 Vendimi Nr.185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar.</i></p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plani mësimor Bachelor në Gjuhë angleze 2021-2022; Programet lëndore të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, vërejmë se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhohet në përditësimin e programit të studimit që ofron. Ndryshimet më të mëdha programi i studimit i ka pësuar me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nenin 71 dhe 73 për organizimin e programeve të studimit.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.7 Vendim SA për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019;</i></p> <p><i>Evidenca II.9 Vendim SA për riorganizimin e planeve 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.7.2 Kthim përgjigje nga MASR për riorganizimin e planeve mësimore;</i></p> <p><i>Evidenca II.7.3 Kthim përgjigje MASR - konfirmim i vënies në dijeni.</i></p>

Konkluzione	<p><i>DGjH disponon informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën, përmbajtjen dhe funksionimin programit të studimit.</i></p> <p><i>Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin të detajuar ku përfshihen kreditet, përmbledhja dhe rezultatet e të nxënit, konceptet themelore që do të trajtohen, kalendarin javor me temat përkatëse, formën e kontrollit të dijeve si dhe literaturën përkatëse.</i></p> <p><i>Veprimtaritë formuese janë të grupuara në kategori që variojnë nga A-E, të ndara në semestër dhe sipas ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë auditorit.</i></p> <p><i>Gjatë kontrollit të DVV u konstatua se programet e lëndëve kishin ndryshime në formatim. <u>GVJ sugjeron</u> që institucioni të rishohë syllabuset e lëndëve duke arritur një unifikim në formatimin e programeve të lëndëve sipas Shtojcës Nr. 2 të VKM . Nr 41. Lidhur me këtë standard, GVJ e konsideron atë të përmbushur kryesisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për thellimin e njohurive të e studentëve. Mungesa e praktikave profesionale që mund të realizohen pranë institucioneve publike apo private shihet nga GVJ si një mangësi për të rritur punësimin e studentëve dhe në përvetësimin e njohurive sipas nevojave të tregut të punës. Institucioni ka në funksion një sërë marrëveshjes institucionale, por kapacitetet e tyre nuk janë shfrytëzuar plotësisht në funksion të programit të studimit, aq më tepër që plani mësimor nuk parashikon një lëndë praktike.</p> <p>Personeli akademik është i përkushtuar ndaj dhënies së njohurive studentëve dhe kjo vërehet edhe në takimin me studentët, ku prej tyre u konfirmua impenjimi i stafit akademik.</p>



	<p>Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë angleze” ka të përcaktuar qartë emërtimin, përmbajtjen e veprimtarive, shpërndarjen e lëndëve, duke grupuar lëndët sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite sipas bazës ligjore në fuqi.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor BA në Gjuhë angleze 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuset) e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023;</i></p> <p><i>Evidenca II.19 Databazë Alumni;</i></p> <p><i>Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ, faqe 9;</i></p> <p><i>Evidenca II.24 Lista e fituesve MA 2018-2019;</i></p> <p><i>Evidenca II.24.1 Lista e fituesve MA 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca II.24.2 Lista e fituesve MA 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca II.24.3 Lista e fituesve MA 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.24.4 Lista e fituesve MA 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësisimit profesional. Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit “Gjuhë Angleze” vihet re se ajo përmban lëndë që bëjnë të mundur aftësimin teorik të studentëve duke i përgatitur si specialistë të gjuhës angleze me formim të thelluar, me njohuri rreth gjuhës, kulturës, letërsisë dhe historisë së gjuhës angleze. Lëndët bazë të detyrueshme i ofrojnë studentit njohuri dhe përgatitje metodologjike ndërsa lëndët karakterizuese ofrojnë njohuri të thelluara në fushën e studimit. Lëndët dhe shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është bërë duke patur parasysh vështirësinë e konceptimit të tyre, hierarkinë e formimit të koncepteve si dhe ndërvarësinë e lëndëve me njëra tjetrën.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mesimor BA në Gjuhë angleze 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuset) e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e</p>	<p>Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Gjuhë angleze”, është hartuar dhe rishikuar në referencë të programeve të ngjashme kombëtare/ndërkombëtare dhe në bazë të sistemit European të Transferimit dhe Mbledhjes së</p>

<p>programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Krediteve (ECTS). Studenti ka një ngarkesë të njëjtë përgjatë semestrave, mesatarisht 30 kredite për semestër. Në disa lëndë praktike kanë prioritet seminarët duke i dhënë rëndësi rritjes së aftësive të studentëve në ushtrimin dhe aplikimin e njohurive teorike të marra në përputhje me profilin e programit. Ngarkesa në kredite për çdo vit akademik është 60 ECTS. Raporti teorik-praktik është në përputhje me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mesimor Bachelor në Gjuhë angleze 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuse) të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023;</i></p> <p><i>Evidenca II.5 Model diplome Bachelor në Gjuhë angleze;</i></p> <p><i>Evidenca II.6.1 Suplementi i diplomës;</i></p> <p><i>Evidenca II.6 Vendim Senati për miratimin e suplementit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në programin e studimit “Gjuhë Angleze”, lëndët/modulet janë përgatitur në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke respektuar dhe legjislacionin në fuqi. Kjo bën më të lehtë transferimin e studimeve apo mobilitetin e studentëve. Studentët e nivelit Bachelor kanë mundësi të transferojnë studimet e tyre në programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integritet të aspekteve teorike dhe praktike që jep një lëndë në përmbushje të objektivave formuese të programit. Në mënyrë të vazhdueshme në këtë program studimi transferohen studentë nga IAL të tjera publike dhe jopublike ose që e zgjedhin këtë program si program të dytë studimi. Formimi teoriko-praktik mundëson punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mesimor Bachelor në Gjuhë angleze 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve;</i></p> <p><i>Evidenca II.19 Databazë Alumni;</i></p> <p><i>Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ.</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe Përgjegjësën e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, GVJ</p>



<p>në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>evidentoi praktikën e punës së institucionit, ku në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit, diskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik.</p> <p>Literatura ofrohet në gjuhën angleze dhe në disa raste gjendet në bibliotekat online.</p> <p>Syllabuset e programit të studimit përmbajnë elementet sipas shtojcës përkatëse të Vendimit Nr. 879, Datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, DATË 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura.</p> <p>Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar. Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar duhet të jenë bashkëkohore. Sipas RVB kjo literaturë përditësohet në mënyrë të vazhdueshme me botime të 5 viteve të fundit.</p> <p>Nga kontrolli i syllabuseve, <i>GVJ konstaton se literatura në programet e disa lëndëve është e pa përditësuar (edhe në rastet kur ka ribotime të titujve të njëjtë) dhe është e nevojshme të rishikohet dhe zëvendësohet me literaturë të viteve të fundit, në zbatim të VKM 41, i përditësuar.</i> Megjithatë, gjatë vizitës në institucion dhe në takimin me stafin akademik, pedagogët përgjegjës pohuan se përditësojnë literaturën plotësuere gjatë orëve të mësimit me pjesë apo publikime të reja për të mundësuar përvetësimin e njohurive.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ-së, neni 19, pika 2/b;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuse) të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023;</i></p> <p><i>Evidenca II.22 Vendimi i Njesisë bazë për miratimin e literaturës bazë të detyrueshme dhe literaturës së rekomanduar, për vitin akademik 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.21 Urdher MASR për përzgjedhjen e literaturës në IAL.</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e</p>	<p>Programi i studimit “Gjuhë Angleze” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në fushën e gjuhësisë, historisë e kulturës. Struktura e programit, raporti teori praktike, përfshirja</p>

dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>e studentëve në kryerjen e detyrave të kursit garantojnë përftimin e kompetencave të synuara.</p> <p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, të pasqyruara në programet lëndore.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor BA në Gjuhë angleze 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuse) të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe/ose punësimit të studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës. Ky program i nënshtrohet një analize për të parë ecurinë dhe nevojat e studentëve që do të përballen me tregun e punës. Formimi i marrë në këtë program studimi u mundëson atyre vijimin e mëtejshëm të studimeve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.19 Databazë Alumni;</i></p> <p><i>Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ, faqe 11;</i></p> <p><i>Evidenca II.24 Lista e fituesve Master 2018-2019;</i></p> <p><i>Evidenca II.24.1 Lista e fituesve Master 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca II.24.2 Lista e fituesve Master 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca II.24.3 Lista e fituesve Master 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.24.4 Lista e fituesve Master 2022-2023.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Lëndët në program përkojnë me objektivat formuese të tij dhe sigurojnë vazhdimësi si në përgatitjen e studentëve ashtu edhe në një vlerësim më objektiv të tyre.</i></p> <p><i>FESHSH ka siguruar bashkëpunim me disa biblioteka online. Literatura ofrohet në gjuhën angleze dhe gjendet në bibliotekat online.</i></p> <p><i>Nga kontrolli i syllabuseve, GVJ konstaton se literatura në programet e disa lëndëve është e pa përditësuar. Rekomandojmë të rishikohet literatura në syllabuset e lëndëve duke u përditësuar me literaturë të viteve të fundit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja synon përmirësimin e vazhdueshëm të programit bazuar në politikat e zhvillimit të UGJ, të cilat janë hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës. Këto politika synojnë rritjen e numrit të projekteve me impakt rajonal dhe për komunitetin si dhe rritjen e numrit të veprimtarive të përbashkëta me organizime me Alumnin të cilat ndikojnë komunitetin. Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” ka siguruar dhe garanton pjesëmarrjen dhe angazhimin e studenteve në panairin e karrierës apo të ndërveprimit praktik me palët e treta si pjesë e transferimit të njohurive si dhe punësimit të tyre.</p> <p>Evidenca <i>Evidenca II.33 Vendim për lëndën Menaxhim projektsh;</i> <i>Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022;</i> <i>Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023;</i> <i>Evidenca II.16.1 Korrespondencë elektronike e Ambasadës Amerikane me UGJ;</i> <i>Evidenca II.16.3 Ngarkesa e pedagogut amerikan gjatë vitit akademik 2021-2022;</i> <i>Evidenca II.16.4 Kurse jashtëshkollore të organizuara nga pedadogu amerikan.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në UGJ, studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale konform Statutit dhe Rregullores së UGJ. Si edhe u konstatua gjatë takimeve të GVJ, përtej përfaqësimit në këto organe, institucioni përfshin opinionet e studentëve në diskutimet e brendshme të njëjësive bazë për përmirësimin e vazhduar të programeve që ofrohen. Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në mënyrë që të përmirësojë programin e studimit “Gjuhë Angleze”, ka siguruar pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve në diskutime të hapura për të përmirësuar aspektet praktike të lidhura me formimin teorik. Studentët janë të angazhuar në Senat Akademik të UGJ, janë të organizuar në Këshillin Studentor të UGJ etj. Nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve Studentore, UGJ mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar për përmirësimin e programit të studimit .</p>

	<p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ, faqe 9;</i></p> <p><i>Evidenca II.1.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik;</i></p> <p><i>Evidenca II.1 Vendim SA për miratimin e anëtareve të SA;</i></p> <p><i>Evidenca II.2 Rregullore e Senatit Akademik;</i></p> <p><i>Evidenca II.26 Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor;</i></p> <p><i>Evidenca 25 Statuti i Këshillit Studentor.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, realizon në mënyrë të përvitshme një analizë në tërësi të aktivitetit të saj, përfshirë edhe atë të nevojave për përmirësim të vazhduar të ofertës së saj didaktike. Në këtë kontekst DGJH është duke shqyrtuar mundësinë e ristrukturimit të programit egzistues ose ose hapjen e një programi të ri studimi.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.16.5 Raporti final mbi përcjelljen e eksperiencës së pedagogut amerikan pranë UGJ.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>DGjH mban kontakte dhe konsultohet me studentët e diplomuar në këtë program dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në komisione të ndryshme ku mund të shprehin mendimet për përmirësimin e programeve të studimeve.</i></p> <p><i>Informacioni që vjen nga bashkëpunimi me palët e treta dhe nga analizat për nevojat e tregut shërben për përshtatjen dhe riorganizimin e programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

III MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” parashikon dispozita të veçanta për sa i përket sigurimit të cilësisë dhe garantimit të standardeve të kërkuara për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në institucion, vërehet se transmetimi i dijeve në auditor realizohet në mënyra të ndryshme.</p> <p>Bazuar në Rregulloret në fuqi, format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, forma të kontrollit të vazhdueshëm, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni, të cilat reflektohen në planin mësimor. Detyrat e kursit të punuara dhe prezantuara në formë eseje ose projekte individuale/në grup kanë një rol të veçantë në vlerësimin përfundimtar.</p> <p><u><i>DGJH nuk e ka të përfshirë në programin e studimit Bachelor në Gjuhë angleze praktikën profesionale.</i></u></p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, neni 22;</i></p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ-së, neni 70;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Njësisë Kryesore FESHSH, neni 26;</i></p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor BA në Gjuhë angleze 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, por edhe me personelin akademik të angazhuar në këtë program, vërehet një frymë bashkëpunimi mes personelit akademik dhe studentëve. Personeli akademik i angazhuar në programin Bachelor “Gjuhë Angleze” implementon metoda të ndryshme të mësimdhënies duke i alternuar ato me teknika të përvetësuar, gjatë programeve të shkëmbimit me universitetet partnere në Evropë e më gjerë. Metodatat e mësimdhënies janë të përzgjedhura sipas nevojave dhe interesit të studentëve. Gjatë vizitës në institucion, në takim me studentët e programit bachelor, studentët u shprehën se mënyrat e organizimit të mësimin janë</p>

	<p>të larmishme, efektive dhe sigurojnë përvetësimin e njohurive dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në mësim edhe nëpërmjet përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit më mësimdhënie (laboratori i gjuhës angleze).</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë angleze, fq.5 (Metodat e mësimdhënies);</i></p> <p><i>Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies;</i></p> <p><i>Evidenca III.1 Urdhër për platformën e mësimin online;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimin online Classroom;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimin online Edumeet;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimin online Office365;</i></p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor BA në Gjuhë angleze 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Konstatohet se personeli akademik është nxitur dhe mbështetur në mënyrë të vazhdueshme duke u bërë pjesë e programeve të ndryshme për mobilitet të personelit akademik në universitete homologe përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit ku personeli akademik ka pasur mundësi të krijojnë përvojë në mësimdhënie në auditorët e këtyre universiteteve.</p> <p>Institucioni gjithashtu mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së mësimdhënies duke ofruar një auditor të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies si edhe nëpërmjet përdorimit të librarive elektronike. Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 në kuadër të zhvillimit të mësimin në distancë, në UGJ janë organizuar trajnime të personelit akademik/ndihmës akademik mbi përdorimin e platformave të mësimdhënies në distancë.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.3 Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DGJH;</i></p> <p><i>Evidenca III.3 Inventari i mjeteve laboratorike në DGJH;</i></p> <p><i>Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ;</i></p>
	<p><i>Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies;</i></p>

	<p><i>Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik;</i></p> <p><i>Evidenca Informacion për bibliotekën U-Library,</i></p> <p><i>Evidenca Fondi i librit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, duke u mbështetur nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnimet dhe pjesëmarrjet në projektet e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është i kualifikuar në fushën e tij/saj të studimit dhe kërkimit.</p> <p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ vëren se personeli akademik përdor metoda interaktive. Studentët e programit shprehen pozitivisht për njohuritë që kanë fituar, për përfshirjen e tyre në jetën e institucionit, për mbështetjen që kanë gjetur në institucion për probleme të ndryshme dhe për trajtimin me respekt nga stafi akademik.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.3 Ligji Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3, 4, 5, 6;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabela 6;</i></p> <p><i>Evidenca III.4 CV-të e Personelit Akademik në funksion të Programit të Studimit;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabela 4;</i></p> <p><i>Evidenca III.2 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Gjuhë angleze në vitin akademik 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në DGJH, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike.</p> <p>Një ndikim të konsiderueshëm në këtë aspekt ka patur edhe eksperiencia e lektorëve të huaj. GVJ vëren nga shqyrtimi i dokumentacionit se strukturat përgjegjëse nuk kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe për këtë arsye e kanë të pamundur të vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Bazuar në DVV dhe informacionin përgjatë vizitës në FESHSH, konstatohet se e vetmja njësi përgjegjëse për</p>

	<p>monitorimin e aftësive të mësimdhënies së personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësia bazë. Drejtuesi i njësisë bazë analizon në fund të çdo semestri performancën e çdo anëtari të departamentit dhe më pas kontakton çdo anëtar për të shprehur gjetjet dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm. Gjatë shqyrtimit të DVV dhe vizitës në insitucion GVJ konstaton se UGJ nuk i përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies me anë të pyetësorëve për vlerësimin e të gjithë aspekteve akademike dhe administrative të jetës studentore. Në DVV janë paraqitur rezultatet e një pyetësi të zhvilluar gjatë periudhës së pandemisë, i fokusuar kryesisht në mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies gjatë përdorimit të platformave online.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor-kërkimor janë Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave dhe Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë të cilat si pjesë përbërëse e Drejtorisë së shërbimeve ndihmës akademike dhe administrative duhet të promovojnë mësimdhënien dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, konstatohet se vlerësimi i cilësisë dhe standardeve nëpërmjet pyetësorëve për studentët nuk realizohet dhe rezultatet e vlerësimit të cilësisë nuk përpunohen dhe nuk përmbledhen në një raport periodik. Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave duhet të përgatisë raportin e vlerësimeve periodike dhe e vë në dispozicion të strukturave drejtuese, personelit akademik dhe palëve të tjera të interesuara. Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies në auditor të personelit akademik.</p> <p>Nga takimet me personelin konstatohet se Departamenti i Gjuhëve të Huaja analizon dhe vlerëson procesin mësimor duke nxjerrë edhe rekomandime për vitin e ardhshëm në përmirësimin e metodave të përdorura. UGJ është angazhuar në disa projekte ndërkombëtare dhe ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare me të cilat inkurajon dhe stimulon stafin të marre pjese në programe shkëmbimi si Erasmus+, ku një nga përfitimet kryesore është përmirësimi i aftësive të personelit akademik në mësimdhënie UGJ ka revistën e tij shkencore “Kërkime Universitare” (në format letër dhe në format elektronik, e pajisur me ISSN: 2226-082X), e cila pasqyron botimet më të fundit të Institucionit.</p>



	<p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 42, neni 84;</i></p> <p><i>Evidenca III.14 Periodikët e botuar në UGJ</i></p> <p><i>Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies;</i></p> <p><i>Evidenca III.5.3 Vendim SA për miratimin e udhëzuesit mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies;</i></p> <p><i>Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Çdo lëndë ndërthur leksione, seminare, detyra kursi, vlerësim të vazhdueshëm dhe vlerësim përfundimtar. Pedagogët përdorin metodat e mësimdhënies me në qendër studentin duke nxitur të menduarit kritik dhe aftësitë për punë kërkimore. DGjH nëpërmjet organizimit të këtij programi siguron arritjen e rezultateve në procesin e të nxënit.</i></p> <p><i>Cilësia e mësimdhënies dhe performanca e personelit akademik është objekt i analizës nga departamenti. UGJ i ka ngritur mekanizmat për monitorimin e brendshëm të cilësisë, por në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, konstatojmë se vlerësimi i cilësisë dhe standarteve nëpërmjet pyetësorëve për studentët është realizuar vetëm gjatë periudhës së pandemisë. <u>Rekomandojmë</u> që Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave të përgatisë raportin e vlerësimeve periodike të cilin e vë në dispozicion të strukturave drejtuese, stafit akademik dhe palëve të tjera të interesuara. Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies në auditor të personelit akademik.</i></p> <p><i><u>GVJ sugjeron</u> që NJBSC dhe Njësia Bazë të bashkëpunojnë për monitorimin e procesit të mësimdhënies, të hartohen më shumë pyetësore dhe të përdoren mekanizma të ndryshëm për monitorimin dhe vlerësimin jo vetëm të mësimdhënies por edhe të kërkimit shkencor, si edhe të shtohet bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm për të ndihmuar në këtë proces. GVJ shprehet se standardi plotësohet kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret dhe udhëzimet institucionale.</p> <p>Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave e të kompetencave profesionale të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” nga studenti.</p> <p>Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë mësimi të çdo semestri. Rregulloret e mësipërme janë të publikuara në faqen web të UGJ-së, ku studentët mund të informohen në lidhje me kriteret e mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Kontrolli i dijeve përbëhet nga disa komponentë. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testeve me shkrim, detyrave të kursit, prezantimeve, provimit të formimit ose tezës së diplomës që paraqitet për mbrojtje në përfundim të mbylljes së të gjitha detyrimeve akademike për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ-së, neni 68,81,82,83;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Nenet 39,40,41,62,63,64;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Nenet 34;</i></p> <p><i>Evidenca I.7 Rregullore e Njesisë Bazë të Gjuhëve të huaja, Nenet 17;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë angleze Kreu III;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuse) të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023;</i></p> <p><i>Evidenca III.12 Vendim Senati për miratimin e tezës së provimeve;</i></p> <p><i>Evidenca III.8 Marrëveshje Bashkëpunimi AADF-UECGJ.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe me personelin akademik, GVJ konstaton se Departamenti i Gjuhëve të Huaja, për programet që mbulon, informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve.</p>

<p>vlërësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Informacioni që marrin studentët nga broshurat informative, java e orientimit, kontakti me pedagogët e departamentit gjatë zhvillimit të lëndëve, syllabuset që u jepen studentëve për çdo lëndë, si dhe rregullorja e programit që ata ndjekin, shërben për tu njohur me vlerësimin në lëndë dhe format e kontrollit të dijeve. Informacioni mbi përmbajtjen e programit të studimit gjendet lehtësisht në ambientet e njësisë bazë. Krahas vlerësimit tradicional, institucioni vë në zbatim sistemin elektronik të testimit dhe vlerësimit, nëpërmjet marrëveshjes së nënshkruar me Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit (AADF) dhe projektit Clean Score, edhe pse gjatë takimeve u konstatua se përdorimi Clean Score është i kufizuar për shkak të numrit të studentëve që ndjekin këtë program.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Nenet 39, pika 4,5;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuse) të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në UGJ vlerësimi i studentit bëhet nëpërmjet vlerësimit të vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e lëndës dhe provimit final. Vlerësimi i vazhduar përfaqëson 20% të vlerësimit përfundimtar. Testimi i njohurive, në përfundim të lëndës zhvillohet me provim me shkrim. Një tezë e provimit me shkrim përmban pyetje ose ushtrime që vlerësohen në total 80 pikë. <i>GVJ vëren</i> se mund të bëhet një kombinimi i vlerësimit me gojë dhe me shkrim, për vetë specifikën e programit.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Nenet 39, pika 5, 6;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023;</i></p> <p><i>Evidenca III.12 Vendimi i unifikimit të tezës së provimit;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve të UGJ-së, Kreu V, Neni. 39, Neni. 40, Neni. 44.</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces</p>	<p>Personeli akademik i DGJH, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies duke u bazuar në konstatimet gjatë procesit mësimor si dhe në kërkesat e studentëve të këtij programi studimi. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion si dhe në takimet me studentët e këtij programi studimi, vihet re se format dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen nga</p>

<p>dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>studentët në komunikim me pedagogun e lëndës, por jo nëpërmjet pyetësorëve.</p> <p><i>GVJ rekomandon përpilimin dhe shpërndarjen e e pyetësorëve dhe aktivizimin e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave në kryerjen e këtij procesi.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>UGJ mbështet personelin akademik në aspektin didaktik për të ndihmuar në zhvillimin e procesit mësimor. Në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe specifikat e tij, mundësohet përdorimi i metodave të përshtatshme të zhvillimit të mësimin në lëndë, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit dhe objektivat formues të programit. Studentët motivohen për projekte praktike individuale apo punime në grup, punime të cilat prezantohen përpara pedagogut të lëndës dhe studentëve të tjerë që frekuentojnë atë lëndë ose në konferenca studentore të realizuara brenda institucionit.</p> <p>Në lidhje me mësimdhënien, pedagogët respektojnë rregullat e institucionit, mbi mënyrën e zhvillimit të orës së mësimin, vlerësimin e studentëve, literaturën dhe materialet që u ofrohen studentëve, etj.</p> <p>Gjatë takimeve me studentët u konfirmua se në fokus të procesit mësimor është angazhimi i studentëve me synimin për të nxitur në mënyrë të vazhdueshme autonominë dhe mendimin kritik të studentëve.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit;</i></p> <p><i>Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.6 Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca III.10 Kodi i Etikës;</i></p> <p><i>Evidenca III.3 Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DGJH;</i></p>




	<i>Evidenca I.21 Lista e mobiliteteve të UGJ;</i> <i>Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ.</i>			
Konkluzione	<p><i>UGJ ka të hartuar qartë dhe në detaje në rregulloret institucionale të gjitha procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e ankimeve apo nevojave për qartësime të studentëve.</i></p> <p><i>Në programin lëndor shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor.</i></p> <p><i>GVJ vëren se mund të bëhet një kombinimi i vlerësimit me gojë dhe me shkrim, për vetë specifikën e programit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të UGJ-së, Rregulloren e FESHSH-së, dhe në Rregulloren e programit të studimit të Bachelor në “Gjuhë angleze”.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ dhe në programin e lëndës, vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës dhe vlerësimi në provimin përfundimtar.</p> <p>Llogaritja e vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e UGj-së, Neni 89;</i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e UGj-së neni 81 pika 1;</i> <i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Kreu V;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, neni 34;</i> <i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë angleze, kreu III.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive në UGJ realizohet duke kombinuar metodat tradicionale si dhe format elektronike si</p>

<p>elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave/projekteve të kursit. Krahas vlerësimit tradicional, Institucioni vë në zbatim sistemin elektronik të testimit dhe vlerësimit, nëpërmjet marrëveshjes së nënshkruar me Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit (AADF) dhe projektin Clean Score.</p> <p><i>Gjatë takimeve <u>u konstatua</u> se Clean Score përdoret në lëndë specifike dhe jo shpesh për shkak të numrit të reduktuar të studentëve.</i></p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.10 Oraret e provimeve online;</i></p> <p><i>Evidenca III.8 Marrëveshja për implementimin e CLEANSORE.</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, studentët konfirmuan se mënyra e vlerësimit të njohurive u bëhet e ditur nga pedagogu i lëndës në javën e parë të leksioneve. Mënyrat dhe format e vlerësimit janë të paraqitura edhe në syllabusin përkatës të lëndës si dhe në rregulloret institucionale.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet duke u bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Vlerësimin e vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës, i cili përbën 20 % të vlerësimit përfundimtar. -Vlerësimi në provim i cili përbën 80 % të vlerësimit përfundimtar. <p>Bazuar në Rregulloren e UGJ në përfundim të procesit mësimor (në orën e fundit të mësimin) çdo pedagog që është përgjegjës lënde u komunikon studentëve fitimin ose jo të së drejtës për të dhënë provimin e lëndës përkatëse dhe rezultatin e vlerësimit të vazhduar. Llogaritja e vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit. Gjatë shqyrtimit të DVB dhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë, GVJ konsatoi se sipas rregulloreve në fuqi në përfundim të procesit mësimor pedagogu i lëndës i komunikon studentëve fitimin ose jo të drejtës për të hyrë në provimin e lëndës në bazë të frekuentimit në masën deri 80%. Sipas rregulloreve në fuqi studentit i jepet e drejta të japë provimin në sezonin e vjeshtës.</p>

	<p><i>GVJ sugjeron të rishikohet kjo pikë në rregulloret institucionale duke specifikuar përqindje të ndryshme për mosfrekuentim dhe në varësi të përqindjeve të përcaktohet nëse studenti mund të hyjë në provim në sezonin e vjeshtës ose të rifrekuentojë përsëri lëndën në vitin pasardhës.</i></p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGj-së, Neni 89, neni 81 pika 1;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 39;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuse) të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen njohuritë dhe puna individuale e studentit.</p> <p>Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregulloreve në fuqi të institucionit. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen njohuritë dhe puna individuale e studentit. Staf i akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Edhe në korrigjimin e provimeve, ato shoqërohen me komente në lidhje me gjetjet e pedagogut dhe motivin e vlerësimit.</p> <p>Deri 8 (tetë) ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu dorëzon në sekretarinë mësimore pasqyrën e rezultateve përfundimtare të provimit në rastet kur nuk ka proces ankimi për rezultatin e provimit nga studenti.</p> <p><i>Gjatë vizitës, <u>GVJ konstatoi se sistemi Pitagora ishte jashtë funksionit.</u></i></p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGj-së, Neni 90;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 46.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiature gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e Departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që</p>

	<p>përdoren (kryesisht për punimet e diplomave), të jenë autentike. Për këto të fundit, përgjegjësinë kryesore për vlerësimin dhe shmangien e plagjiaturës e ka pedagogu udhëheqës. Çdo anëtar i personelit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara, është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar dhe Kodit të Etikës. Studentët, janë të detyruar të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës së Universitetit “Universitetit Eqrem Çabej” Gjirokastër, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit në këtë Universitet, përfshirë këtu edhe dispozitat që parashikojnë sjelljen e tyre (moskopjimi, mosmashtrimi gjatë procesit mësimor, plagjiaturat e çdo forme, etj.), të përcaktuara në Kodin e Etikës.</p> <p>GVJ konstaton se kontrolli i plagjiaturës në punimet e diplomave ose në detyrat e kursit, merret përsipër nga pedagogu dhe është përgjegjësi e tij/saj. Gjatë takimeve me personelin akademik u konstatua se ky kontroll kryhet në mënyra dhe me programe të ndryshme. Institucioni nuk ofron programe të kontrollit antiplagjiaturë, përdorimi i të cilave mund të unifikojë mënyrat e kontrollit dhe gjetjet.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.10 Kodi i Etikës, Nenet 23,24, 25,26;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 44, pikat 9, 10;</i></p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGj-së, nenet 86, 87, 88.</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët njihen me mënyrën e vlerësimit si dhe përqindjet përkatëse në fillim të procesit mësimor. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Teza e provimit, bazuar në Rregulloren e UGJ, përmban pyetje që përfshijnë në mënyrë tërësore lëndën përkatëse, dhe për çdo pyetje/ushtrim paraqiten pikët përkatëse.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore konstaton se vlerësimi kryhet me sistem pikësh i përkthyer në bazë notash. Nota më e ulët kaluese është nota 5. Rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve nga pedagogu i lëndës në orën dhe sallën e dakordësuar paraprakisht me studentët. Gjatë vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, quiz-e, prezantime në grup ose individuale, etj.</p> <p>Evidenca</p>




	<p><i>Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, neni 8, pika 2;</i></p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGj-së, Neni 81, pika 1, Neni 90;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH, Neni 35, pika 6, 16;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të studimit Bachelor në "Gjuhë angleze" fq.11, pika 6.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, njihen me vlerësimin e dijeve dhe kërkesën për rishikim të vlerësimit. Në raste paqartësish, ata kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të komisionit të provimit, për të marrë sqarimet e duhura. Referuar takimit me studentet, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim, sikurse është e saktësuar edhe në rregulloren e UGJ. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës, të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare.</p> <p>Pas kësaj faze, sërish studentit ka të drejtën e kontestimit të notës duke paraqitur kërkesë pranë Dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Kërkesa shqyrtohet dhe nëse pranohet, analizohet nga një komision <i>ad-hoc</i> i ngritur me pedagogë të disiplinës që po vlerësohet.</p> <p>Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi, u vu re se studentët marrin përgjigje rreth çdo paqartësie të mundshme me pedagogët e lëndës, pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGj-së, Neni 90;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ Nenet 45, 46;</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Të drejtat e studentit janë të përcaktuara në rregulloret institucionale. Në këto rregullore përcaktohen mënyrat se si dhe kur studenti mund të kryejë një ankesë, si shqyrtohet ajo dhe mënyra e informimit. Studentët në Universitetin "Eqrem Çabej Gjirokastër, gëzojnë të drejtën të njihen me vlerësimin e dijeve dhe kërkesën për rishikim të vlerësimit për të gjitha format e kontrollit të dijes të përcaktuara në syllabusin e lëndës përpara se ky vlerësim të marrë formën përfundimtare dhe njëkohësisht në raste paqartësish, ata kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të komisionit të provimit, për të marrë</p>

	<p>sqarimet e duhura. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion nuk u vu re një praktikë konkrete, pasi studentët nuk kishin patur ankesa/kërkesa që të kërkonin përshkallëzime përtej njësisë bazë.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGj-së, Neni 90;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ Nenet 45, 46.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UGJ ka të hartuar qartë dhe në detaje në rregulloret institucionale të gjitha procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e ankimimeve apo nevojave për qartësime të studentëve. Institucioni vë në zbatim edhe sistemin elektronik të testimit dhe vlerësimit, i cili eliminon forma të ndryshme abuzimi dhe rrit transparencën.</i></p> <p><i>Për shmangjen e plagjiaturës, kopjimin në provime dhe detyra bëhet administrimi i provimeve sipas përcaktimit të rregulloreve.</i></p> <p><i>Llogaritja e vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit. Gjatë shqyrtimit të DVB dhe gjatë takimeve me stafin akademik e drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë, GVJ konstatoi se në përfundim të procesit mësimor pedagogu i lëndës i komunikon studentëve fitimin ose jo të të drejtës për të hyrë në provimin e lëndës në bazë të frekuentimit në masën deri 80%. Sipas rregulloreve në fuqi studentit i jepet e drejta të japë provimin në sezonin e vjeshtës.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron të rishikohet kjo pikë në rregulloret institucionale duke specifikuar përqindje të ndryshme për mosfrekuentim dhe në varësi të përqindjeve të përcaktohet nëse studenti mund të hyjë në provim në sezonin e vjeshtës ose të rifrekuentojë përsëri lëndën në vitin pasardhës.</i></p> <p><i>Gjithashtu, GVJ konstaton se kontrolli i plagjiaturës në punimet e diplomave ose në detyrat e kursit, merret përsipër nga pedagogu dhe është përgjegjësi e tij/saj. Gjatë takimeve me stafin akademik u konstatua se ky kontroll kryhet në mënyra dhe me programe të ndryshme. Institucioni duhet të ofrojë programe të kontrollit antiplagjiaturë, përdorimi i të cilave mund të unifikojë mënyrat e kontrollit dhe gjetjet.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




Standardi III.4

Institucioni ngrë struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë teorike dhe praktike në gjuhën angleze si dhe përmbillet me punimin e diplomës ose me provim formimi.</p> <p>Programi zhvillohet në 24 lëndë dhe synon thellimin e njohurive dhe aftësimin profesional të studentëve.</p> <p>Programi “Gjuhë Angleze” synon arsimimin dhe formimin e specialistëve në fushën e gjuhës angleze si dhe synon të krijojë tek studentët aftësi interpretuese, analitike dhe zbatuese të përfuara gjatë periudhës së studimit në këtë program, me impakt në sferën profesionale. Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor në BA 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuse) të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023</i></p> <p><i>Evidenca II.3 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018;</i></p> <p><i>Evidenca II.3.1 VKM Nr. 879, Datë 18.12.2019;</i></p> <p><i>Evidenca II.3.2 VKM Nr. 185, datë 25.3.2021.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit “Gjuhë Angleze” është pjesë e programeve të ciklit të parë të studimeve që ofron Departamenti i Gjuhëve të Huaja dhe synon të zhvillojë aftësi në fushën e gjuhës angleze, si ato gjuhësore përmes disiplinave si gramatika, semantika, leksikologjia, hyrja në gjuhësi, etj., dhe letrare përmes disiplinave të letërsisë angleze, letërsisë amerikane.</p> <p>Ky program ofrohet në gjuhën angleze, por ka edhe lëndë në gjuhën shqipe.</p> <p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë të harmonizuara midis tyre në shtrirjen e tyre në semestra, me qëllim që studenti të marrë në mënyrë të integruar dhe të thellojë aftësitë profesionale e të veçanta në fushën e gjuhës angleze dhe më gjerë.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton</p>	<p>Referuar takimit me personelin akademik, GVJ konstaton se studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e</p>

<p>studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>pyetjeve që do të ketë provimi përfundimtar dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën përfundimtare të modulit. Në syllabuset e çdo lënde studentët kanë informacion në lidhje me kompetencat, aftësitë dhe rezultatet e të nxënit. Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në lëndë mund të evidentohen përmes vlerësimit të studentit gjatë semestrit ku zhvillohet lënda. Syllabuset e kurseve përmbajnë qëllimin dhe rezultatet e të nxënit.</p> <p>Në përfundim të lëndës/modulit personeli akademik bën një vlerësimi të nivelit të përfitimit të kompetencave të synuara në syllabusin e lëndës/modulit. Rishikimi periodik i programit të studimit bëhet në bazë të ecurisë së studentëve në çdo lëndë/modul për nivelin e kompetencave dhe aftësive që ata kanë fituar dhe konkluzionet e nxjerra nga analizat e kryera në grupet lëndore dhe në departament, të cilat reflektohen në përmirësimin e programit të studimit.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III. 4 Plan mësimor në BA 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca III.1.11 Orari i konsultimeve gjatë periudhës së pandemisë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të</p>	<p>Lëndët janë të ndërtuara në bazë të kërkesave të tregut të punës, të përkthyer në nivel kompetencash për secilën lëndë. Studentit i krijohet mundësia të zbatojë këto kompetenca gjatë orëve të seminareve dhe praktikës profesionale, e cila është një lëndë e veçantë. Programet lëndore në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë angleze”, kanë të përfshirë rezultatet e të nxënit në formën e kompetencave që fiton studenti.</p> <p>Njohuritë e marra teorikisht zhvillohen më tej në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Realizimin e orëve të ushtrimeve/ laboratoreve në auditor - Studimin individual jashtë auditorit - Realizimin e projekteve apo detyrave të kursit, etj. <p>Personeli akademik i DGJH mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara duke krijuar kushtet e duhura për mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023;</i></p> <p><i>Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ;</i></p>

mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p><i>Evidenca II.15.2 Pjesëmarrje e studentëve në projektin "Zgjerimi i aftësive përmes të mësuarit të gjuhës angleze";</i></p> <p><i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuse) të Programit të studimit Bachelor në Gjuhë angleze 2022-2023.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Përgjatë vitit akademik, njësia bazë dhe ajo kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, organizon në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime, orë informuese etj. për studentët. Këto orë mund të drejtohen nga personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. Këto aktivitete realizohen jashtë strukturës së programit të studimit dhe në orare që nuk bien ndesh me procesin mësimor. UGJ/Departamenti i Gjuhëve të Huaja, organizon edhe trajnime/aktivitete të dedikuara për personelin. Në këtë kontekst janë zhvilluar disa orë të hapura leksionesh dhe seminaresh nga anëtarë të personelit akademik të DGJH edhe me pjesëmarrjen e disa lektorëve të huaj të ftuar.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.16.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UOGJ 2022-2023;</i></p> <p><i>Evidenca III.16.3 Plani i veprimtarive të DGJH 2022-2023.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht. Përmbajtja e programit u mundëson dhe u garanton studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave profesionale. Përveç formimit profesional të studentëve i kushtohet rëndësi edhe zhvillimit të aftësive të veçanta.</i></p> <p><i>Bazuar në rregulloret në fuqi departamenti mbështet studentët gjatë gjithë procesit mësimor. Për të realizuar këtë, shërbimet dhe mjetet janë vënë në dispozicion të studentëve. Studentët mbështeten në konferenca të organizuara nga Universiteti/Fakulteti por edhe në konferenca studentore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni parashikon procesin e diplomimit të studentëve në aktet e brendshme rregullatore. Rregullorja e FESHSH dhe ajo e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, paraqesin qartë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në këtë program studimi.</p> <p>Procedura më specifike për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës, gjenden në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”. Ky program studimi mbyllet me provimi të përgjithshëm formimi ose punim të diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare. Diplomimi i studentit kryhet vetëm pasi ai ka shlyer/realizuar të gjitha detyrimet e tjera të këtij program studimi. Zhvillimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimi i diplomës për studentët e programit e ciklit të parë Bachelor në Gjuhë angleze mbështetet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kreun VIII “Diplomimi”, të Rregullores së Studimeve në UGJ, Nenet 59, 60, 61, 62, 63, dhe 64; - Nenin 93 të Rregullores së UGJ; - Kreun VII “Diplomimi”, nenet 38, 39 të Rregullores së FESHSH; - Rregulloren e Njesisë Kryesore FESHSH, neni 39; - Rregulloren e Programit të studimit BA, fq.14.
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Përgjegjëse për mbarëvajtjen e të gjithë procesit akademik, përfshirë edhe diplomimin e studentëve, është njësia bazë, Departamenti i Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Kërkesat e studentëve bazuar në rezultatet e tyre dhe në notën mesatare shqyrtohen në departament, ku dhe hartohen listat e studentëve që do të zhvillojnë provim formimi ose temë diplome. Studentët të cilët do të zhvillojnë provimin e formimit udhëzohen nga personeli akademik efektiv i Departamentit të Gjuhëve të Huaja, në seanca orientuese. Studentët të cilët do të mbrojnë temën e diplomës propozojnë udhëheqës shkencor nga stafi akademik efektiv në departament, së bashku me temën e propozuar. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga departamenti dhe u bëhen me dije studentëve. Studentët udhëzohen nga pedagogët udhëheqës për punimin e temës së diplomës, miratuar në Departamentin e Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 61 dhe shtojcat e kësaj Rregulloreje;</i></p> <p><i>Evidenca III.11.2 Manuali i punimit të diplomës, Shtojca 1,2,3,4,5,6;</i></p>



	<p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Gjuhë angleze, fq.14;</i></p> <p><i>Evidenca III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në "Gjuhë angleze".</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se teza e provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve. Komisioni i provimit përgatit tezen për provimin e përgjithshëm përfundimtar bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p> <p>Tezat e provimit përmbajnë pyetje nga fushat që përfshihen në programin e formimit. Tezat e provimit të formimit hartohen nga anëtarët e komisionit, firmosen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 62, pika 2,3,4; Neni 64;</i></p> <p><i>Evidenca III.11 Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në "Gjuhë angleze".</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve me GVJ, personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e temës së diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik. Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullores së studimeve në UGJ.</p> <p>Studenti fiton të drejtën e mbrojtjes së punimit përpara komisionit, mbasi është marrë miratimi i udhëheqësit i cili ka rojl këshillues/udhëzues për studentin në realizimin e punimit të diplomës.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 61;</i></p> <p><i>Evidenca III.11.2 Manuali i punimit të diplomës, Shtojca 1, 2,3,4,5,6;</i></p> <p><i>Evidenca III.11.1 Miratimi i fushave të studimit.</i></p>

<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni vendos në dispozicion të studentëve fondin e bibliotekës së UGJ. Për përgatitjen e temës së diplomës, mjediset e fakultetit/, si p.sh. laboratorit, biblioteka etj. mund të përdoren nga studentët dhe nga stafi i Departamentit të Gjuhëve të Huaja për realizimin e detyrimeve akademike ose kërkimore, apo për hedhjen e të dhënave tabelare, grafike dhe të analizës statistikore, etj. që mund t'i duhen një studentit për të përgatitur temën e tij/saj të diplomës.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Punimi i diplomës ose provimi përfundimtar, në planin mësimor vlerësohet me notë, njësoj si çdo lëndë tjetër e këtij programi studimi.</p> <p>Vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës pasqyrohet në procesverbalin përkatës.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ Neni 62, pika 5 dhe 6, Neni 64 pika 3 dhe 4;</i></p> <p><i>Evidenca III.11.2 Manuali i punimit të diplomës, Shtojca 1,2,3,4,5,6.</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, institucioni ka të miratuar modelin e diplomës nga QSHA (Qendra e Shërbimeve Arsimore).</p> <p>Në përfundim të këtij programi studimi, pasi studentit ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, të miratuara nga MASR. Diploma me të cilën pajiset studentit është dokument zyrtar. Suplementi i Diplomës për programin e studimit Bachelor në Gjuhë angleze është në përputhje me Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës" të MASR-së. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës. Pas diplomimit, me kërkesën e tij/saj, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, me syllabuset përkatëse.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në UGJ Neni 65;</i></p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ-së Neni 76;</i></p> <p><i>Evidenca II.5 Modeli i diplomes Bachelor në Gjuhë angleze;</i></p> <p><i>Evidenca II.6.1 Suplementi i diplomës;</i></p>

	<p><i>Evidenca II.6.2 Udhëzimi nr. 11, dt. 02.04.2020 "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës" të MASR.</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstatohet se dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, vihet re një organizim i mirë i arkivës dhe i materialeve për çdo student, lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë.</p> <p>Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti, dhe jepet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore. Studentët, në mbyllje të viteve të studimit, kanë të drejtë të tërheqin dokumentacionin personal. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucioni kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>UGJ administron regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 44;</i></p> <p><i>Evidenca III.13 Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Neni 4.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UGJ ka të përcaktuar qartë procedurat e përfundimit të studimeve, mbrojtjes së diplomës dhe të provimit të formimit.</i></p> <p><i>UGJ pajis studentët me diplomë sipas standardit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin e saj. DGjH ka hartuar një procedurë të posaçme për detyrimet përmblyëse, të cilën e bën publike dhe siguron transparencë dhe realizim të tyre.</i></p> <p><i>Procedura e mbrojtjes së diplomës përcaktohet nga rregullorja përkatëse. Në përfundim të programit të studimit studenti pajiset me diplomën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Sekretaria mësimore e FESHSH ruan dokumentacionin e studentit dhe lëshon dokumenta sipas kërkesës së studentëve dhe sipas rregullave në fuqi. GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1																																																	
<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</p>																																																	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Lidhur me këtë kriter, GVJ ka verifikuar se në lidhje me programin e studimit “Gjuhë Angleze”, Universiteti Egerem Çabej, Gjirokastër ndjek procedura të rregullta ligjore për rekrutimin e personelit. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar për periudhën 2020-2022 është si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2021 - 2022</th> <th colspan="2">2022 - 2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>5</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>7</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>6</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>14</td> <td>1</td> <td>14</td> <td>1</td> <td>15</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p>Procedurat janë të përcaktuara qartë në rregulloren e njësisë kryesore, rregulloren e njësisë bazë dhe statutin e universitetit. Gjatë takimit me personelin akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshëm, rezultoi se këto procedura ndiqen dhe se për rekrutimin e personelit akademik janë zbatuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe përfaqësuesja e zyrës së burimeve njerëzore pranë këtij universiteti duke specifikuar ndër të tjera se zyra e burimeve</p>	Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	-	-	-	-	-	-	Prof.As.Dr	2	-	4	-	5	-	Dr/PhD	7	1	5	1	4	1	Msc	5	-	5	-	6	-	Në total	14	1	14	1	15	1
	Tituj/grada		2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023																																										
PAE		PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																																											
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-																																											
Prof.As.Dr	2	-	4	-	5	-																																											
Dr/PhD	7	1	5	1	4	1																																											
Msc	5	-	5	-	6	-																																											
Në total	14	1	14	1	15	1																																											

njerëzore njofton kandidatin në rast të moskualifikimit ose skualifikimit nga procedura, mbështetur në bazën ligjore.

Gjatë vizitës në institucion, përveç takimeve të drejtëpërdrejta me stafin akademik, GVJ-së iu vu në dispozicion edhe dokumentacioni i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi me kohë të plotë dhe të pjesshme. Nga verifikimet rezultoi se personeli i angazhuar në mësimdhënie ishte i kategorive asistent lektor, lektor, profesor i asociuar dhe profesor, sipas legjislacionit në fuqi. Cv-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik ishin në përputhje me fushën të cilën ato mbulonin. Kjo gjë është e pasqyruar edhe në planet mësimore të personelit akademik. Personeli akademik është i angazhuar në aktivitete kërkimore shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, sikurse pasqyrohet edhe në raportet vjetore të veprimtarisë mësimore. Megjithatë, në dosje mungonte leja nga punëdhënësi për tu angazhuar si asistent lektor me kohë të pjesshme si edhe kontrata pune me mangësi të tilla si, mosplotësimi i datës së fillimit dhe përfundimit të kontratës dhe kontrata të pafirmosura dhe vulosura nga Rektori.

Evidenca

Evidenca I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DGJH 2018-2019;

Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DGJH 2019 -2020;

Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DGJH 2020-2021;

Evidenca I.13.3 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DGJH 2021-2022;

Evidenca I.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FESHSH 2018-2019;

Evidenca I.12.2 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FESHSH 2019-2020;

Evidenca I.12.4 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FESHSH 2020-2021;


Evidenca I.12.5 Vendim Dekani për miratimin e Raportit vjetor 2020-2021

Evidenca I.12.6 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FESHSH 2021-2022;

Evidenca I.12.7 Vendimi i Dekanit FESHSH për miratimin e Raportit vjetor 2021-2022
Vendimi i Dekanit për miratimin e raportit vjetor 2021-2022;



	<p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabela 6.1, 6.2, 6.3 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Bachelor në Gjuhë angleze;</i></p> <p><i>Evidenca III.4 CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabelat 6.1, 6.2, 6.3 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Bachelor në Gjuhë angleze</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për këtë kriter, GVJ konfirmoi ngarkesën mësimore të personelit akademik që mbulon programin Bachelor në Gjuhë Angleze. Në varësi të nevojave të Njesisë Kryesore ose Njesisë Bazë, institucioni angazhon personel akademik jo vetëm në fillim të vitit por edhe përgjatë tij, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Gjate vizitës në institucion, GVJ u njoh me procedurën e shpërndarjes së ngarkesës mësimore, si edhe programet e lëndëve nga çdo personel akademik i angazhuar në këtë program.</p> <p>Numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në tre vitet e fundit akademike (sipas të dhënave të tabelës 12) është në përputhje me kërkesat sipas legjislacionit në fuqi sipas të cilit PAE duhet të realizojnë të paktën 75% të ngarkesës mësimore në auditor.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca IV.1 V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017, pika 2, gërma a, nënpika xii, pika 2, gërma b, nënpika i, nënpika ii;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës;</i></p> <p><i>Evidenca IV.13.2 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime</p>	<p>Mbështetur në statutin dhe rregulloren e njesisë kryesore dhe njesisë bazë, departamenti administron informacionin në lidhje me aktivitetin akademik dhe administrativ. Ky informacion dokumentohet nëpërmjet planeve mësimore, syllabuseve, ngarkesës administrative dhe akademike. Gjithashtu, UGJ garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik.</p> <p>Evidenca</p>



shoqërore dhe shëndetësore.	<i>Evidenca IV.3 Listëpagesa, Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik Janar-Maj 2023</i>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procesi i rekrutimi të personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme realizohet mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Procedurat janë të pasqyruara edhe në rregulloren e institucionit. Në takim me drejtuesin e njësisë kryesore, njësisë bazë por edhe të personelit akademik, rezultoi se procedura e ndjekur është në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi. Nëse njësia kryesore dhe njësia bazë ka nevojë për personel, shpallet konkursi për vende të lira pune. Fillimisht përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe të posaçme, kërkesa i përcillet rektorit të universitetit dhe më pas publikohet në faqen zyrtare të web, aplikimet dorëzohen në zyrën e burimeve njerëzore dhe jo nëpërmjet rrugës postare. Pasi përfundon afati i dorëzimit të aplikimit vlerësohen dosjet nga një komision ad-hoc i ngritur nga Rektori në rastin e aplikimit për personel akademik me kohë të plotë dhe nga drejtuesi i njësisë kryesore për aplikimet si personel akademik me kohë të pjesshme.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 56; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenet 27, 29;</i></p> <p><i>Evidenca I.27 Rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrativ, Nenet 3, 5, 8 dhe 9</i></p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 27</i></p> <p><i>Evidenca IV.4 Propozim për personel akademik me kohë të plotë, Evidenca IV.4.1 Propozim për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 33, gërma “h”</i></p> <p><i>Evidenca IV.6 Procedurë e punësimit të personelit akademik në DGJH</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 33, gërma “f”</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve</p>	<p>Për realizimin e mësimit në programin e studimit Bachelor në gjuhë angleze, UGJ siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik. Personeli ndihmon gjithashtu në mirëmbajtjen e laboratorëve të cilët janë të rëndësishëm pasi shërbejnë si një urë lidhëse mes teorisë dhe praktikës në këtë fushë studimi, duke i ndihmuar studentët të vendosin në praktikë njohuritë teorike të përfutuara gjatë leksioneve dhe</p>

<p>laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>seminareve. Deri në vitin akademik 2020-2021 pjesë e departamentit ishte edhe një personel ndihmës akademik i cili ndihmonte në realizimin e orëve laboratorike si edhe në mirëmbajtjen e tyre.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 45; Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 37;</i></p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Neni 15</i></p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Kreu II, Neni 3;</i></p> <p><i>Evidenca IV.7 Model dosje personeli.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga takimi i zhvilluar me GVJ në UGJ rezultoi se pranë këtij institucioni funksionon Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari-Protokoll, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakadematike Administrative (DSHNA), e cila është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave personale të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, sikurse është e parashikuar në rregullore dhe aktet ligjore në fuqi. Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, u konfirmua nga përfaqësuesja e sektorit se përditësimi i të dhënave të personelit me kohë të plotë apo të pjesshme, personelit ndihmës akademik dhe administrativ, realizohet çdo vit në mënyrë periodike. GVJ vëren se ky përditësim është aplikuar mbi një pjesë të dosjeve të personelit. Ndërkohë në disa nga dosjet e shqyrtuara, të vëna në dispozicion nga përfaqësuesja e sektorit, u vu re mungesë dokumentacioni që lidhet kryesisht me lejen nga punëdhënësi ose plotësim i kontratave me detaje si data ose vula. Përfaqësuesja e këtij sektori gjatë takimeve konfirmoi se çdo vit sektori realizon përditësimin e të dhënave të personelit, me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme si edhe të personelit ndihmës-akademik dhe administrativ. Ky përditësim është i pasqyruar në disa nga dosjet të cilat u shqyrtuan gjatë takimit të GVJ. Megjithatë, në disa raste të tjera kishte dosje të cilat kishin nevojë për plotësim dokumentacioni si, leje nga punëdhënësi ose plotësim i kontratave me detaje si data ose vula.</p>
	<p>Gjithashtu, GVJ konstatoi se Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë mbledh, ruan dhe përditëson të dhëna mbi kërkimin shkencor të personelit akademik, pjesmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, mobilitete dhe</p>

pjesëmarrje në trajnime e Workshope. Lidhur me këtë, përfaqësuesja e Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë konfirmoi se mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit që universiteti ka me uiversitetet e tjera në kuadër të projekteve ndërkombëtare si Erasmus+, personeli akademik merr pjesë në programet e shkëmbimit si teaching dhe training në universitetet ndërkombëtare. Gjithashtu, personeli akademik gjatë takimeve konfirmoi se kanë gjetur mbështetje te ky sektor kur kanë kërkuar ndihmë në plotësimin e dokumentacionit apo detaje mbi mobilitetin. Ky sektor, jo vetëm njofton personelin mbi mobilitetet e reja por edhe i asiston ato që në momentin e nënshkrimit të kontratës e deri në përfundimin e mobilitetit. Nga ana tjetër, gjatë takimeve personeli akademik u shpreh se përveç shkëmbimeve Erasmus+, ata mund të aplikojnë edhe në programe të tjera. Disa u shprehën se kanë aplikuar në AKKSHI ose në programe të BE. Sipas UGJ këto projekte ndihmojnë në zhvillimin profesional të personelit akademik por edhe në përfshirjen e studentëve kur projekti e parashikon. Megjithatë, mbetet të theksohet fakti se pavarisht aplikimeve, numri i projekteve të fituara mbetet i ulët dhe se stafi duhet të punojë më shumë në këtë drejtim. Gjithashtu nuk mungojnë as publikimet e punimeve shkencore apo pjesëmarrjet në konferenca. Dukeqenë se buxheti për mbështetjen financiare të kërkimit shkencor është i ulët, shpeshherë personeli akademik detyrohet ti mbulojë vetë shpenzimet por nuk mungojnë edhe rastet kur UGJ ka mbështetur financiarisht aktivitete shkencore të personelit akademik.

Të dhëna të tjera të përditësuara lidhen me angazhimin e personelit akademik në çdo vit akademik dhe semester si dhe planifikimin e kohës vjetore të punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik, të dhëna që arkivohen pranë DGJH-së. Sikurse u konfirmoua edhe në takimin me GVJ, Përgjegjësi i Departamentit bën përditësimin e këtyre të dhënave çdo vit.


Evidenca

Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Nenet 41, 42;

Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, nenet 4, 5;

Evidenca IV.7 Model dosje personeli;

Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 17;



	<p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave shoqërore, Neni 46;</i></p> <p><i>Evidenca IV.8 Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik; Evidenca IV.8.1 Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik;</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 45, pika 3;</i></p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 41;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave shoqërore, Neni 15;</i></p> <p><i>Evidenca IV.7 Model dosje personeli;</i></p> <p><i>Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara në UGJ, GVJ u njoh me partneritete të ndryshme që institucioni ka në mënyrë që ti vijnë në ndihmë procesit mësimor. Marrëveshjet e bashkëpunimit vijnë si një ndihmë e madhe në realizimin e praktikave në formën e intership-eve, sipas programit të studimit. Megjithatë, mbështetur në planin mësimor Bachelor në gjuhë angleze, praktika profesionale nuk është e parashikuar si një lëndë e detyruar.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Gjuhë Angleze 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca III.11.1. Miratimi i fushave të studimit;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 61;</i></p> <p><i>Evidenca III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat 1,2,3,4,5,6 të Rregullores së Studimeve.</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë</p>	<p>Mbështetur në planin mësimor të ngarkuar online nga UGJ, programi Bachelor në "Gjuhë Angleze" nuk e përfshin praktikën e detyruar profesionale në studimet 3 vjeçare.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Gjuhë Angleze 2021-2022.</i></p>

pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.				
Konkluzione	<p><i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar për realizimin e programit të studimit, përmbush kriteret ligjore në fuqi, duke patur nivelin e duhur të kualifikimit, mbulimin e ngarkesës mësimore. Institucioni dëshmon qëndrueshmëri të personelit të angazhuar.</i></p> <p><i>Gjtihashtu procedura e ndjekur për rekrutimin realizohet me procedurë konkurimi të hapur, duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv, në përgjigje të nevojave specifike të njësisë. Të dhënat në lidhje me personelin mblidhen dhe ruhen nga sektori përkatës, por dosjet duhet të përditësohen në tërësinë e tyre, me të gjithë dokumentacionin e kërkuar ligjor.</i></p> <p><i>Për zhvillimin e praktikave mësimore, ato nuk gjenden të pasqyruara në planin mësimor si lëndë e detyruar, por ofrohen në sajë të bashkëpunimeve në formën e intershipeve. Për sa më lart, GVJ vlerëson së ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në takimet zhvilluar në UGJ si edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm, institucioni e zhvillon veprimtarinë mësimore në mjedise me infrastrukturë të kompletuar dhe komode, të cilat janë të përshtatshme për këtë program studimi, duke qenë gjithnjë në përputhje me natyrën specifike të tij. Konkretisht mësimi për këtë program studimi zhvillohet në godinën universitare B e cila plotëson kushtet higjieno sanitare për studentët dhe personelin akademik. Mbështetur në raportin e MAS për kapacitetet pritëse UGJ plotëson kriterin e normativës të parashikuar në V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017. Duhet theksuar fakti që programi i studimit Bachelor në Gjuhë Angleze zhvillon mësimim vetëm gjatë paradites.</p> <p>Evidenca</p>

	<p><i>Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca IV.10.1 Leje higjeno sanitare;</i></p> <p><i>Evidenca IV.10.2 Çertifikatë për sigurinë nga zjarri;</i></p> <p><i>Evidenca IV.13.2 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca IV.1 V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017;</i></p> <p><i>Evidenca II.13.2 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024;</i></p> <p><i>Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16).</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ambientet mësimore në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze janë të pajisura me sisteme wireless, me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit të cilat krijojnë kushtet për realizimin me standarde dhe cilësi të aktivitetit mësimor.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.3 Inventari i mjeteve laboratorike në DGJH.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mjediset në dispozicion të programit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një mbarëvajtje të procesit mësimor. Sallat kanë një akustikë të mirë dhe janë tepër komode për zhvillimin e orës mësimore. DGJH disponon një laborator të Gjuhëve të huaja të pajisur me PC, rrjete kompjuterike dhe WIFI Internet, videoprojektor në të cilin zhvillojnë leksione të integruara me praktikën studentët e këtij program studimi.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.3 Inventari i mjeteve laboratorike nëDGJH.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së</p>	<p>DGJH disponon një laborator të Gjuhëve të huaja të pajisur me PC, rrjete kompjuterike dhe WIFI Internet, videoprojektor në të cilin zhvillojnë leksione të integruara me praktikën studentët e këtij program studimi. Laboratori plotëson</p>

informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<p>standardet për të garantuar realizimin e procesit mësimor përmes përdorimit të metodave teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca III.3 Inventari i mjeteve laboratorike në DGJH.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Gjatë takimit në UGJ dhe mbështetur në evidencat e vëna në dispozicion, GVJ konstatoi se institucioni e zhvillon veprimtarinë mësimore në mjedise me infrastrukturë të përshtatshme për këtë program studimi, në përputhje me natyrën specifike të tij. Ambientet janë të pajisura me sisteme ëireless, mjete teknologjike të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor si edhe ka në dispozicion një laborator me pajisje të kohëve të fundit të cilat e afrojnë studentin më pranë profesionit të tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Mbështetur në vizitën e kryer në institucion si edhe në takimet me personelin akademik, GVJ konstatoi se literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar me të cilën punojnë studentët e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze përbëhet nga tekste mësimore si edhe cikle leksionesh të përgatitura nga pedagogët. Këto të fundit ia dërgojnë ciklet e leksioneve studentëve nëpërmjet adresës së email-it. Përveç literaturës fizike në bibliotekën e universitetit, UGJ vë në dispozicion dy platforma, konkretisht Ulibrary, GenesisLibrary nga të cilat mund të shkarkohen literature primare dhe dytësore të cilat janë të domosdoshme në këtë program studimi. Përveç literaturës në gjuhë të huaj e cila zë një vend të konsiderueshëm në bibliotekën e universitetit, vihet në dispozicion edhe literaturë shqip kryesisht në lëndët e gjuhës dhe letërsisë shqipe, të cilat janë të nevojshme për marrjen e dijeve në këtë program studimi.</p>

	<p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 27;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave shoqërore, Neni 22</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave shoqërore, Neni 22;</i></p> <p><i>Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Neni 16;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, fq.3;</i></p> <p><i>Evidenca IV.12 Miratimi i literaturës bazë në DGJH 2020-2021; Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Në takimin e zhvilluar në UGJ, GVJ u njoh me procedurën e pasurimit të bibliotekës me tituj të rinj për tu vënë në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. Përgjegjësi i njësisë bazë dhe punonjësit e bibliotekës deklaruan se përpara miratimit të buxhetit vjetor institucional, paraqesin propozimet respektive për përditësimin e literaturës me botimet më të fundit të fushës. Gjithashtu GVJ u njoh edhe me një mënyrë tjetër të pasurimit të lieteraturës e cila mbështetet në donacione private.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca IV.13 Kërkese për blerje librash;</i></p> <p><i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në UGJ rezultoi se biblioteka gjendet në godinën C të universitetit. Salla e studimit është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për të garantuar studim të qetë për studentët dhe stafin akademik. Biblioteka disponon një fond të konsiderueshëm literature të huaj dhe shqipëtare, përkatësisht 620 tituj në dispozicion të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. Përditësimi i fundit i literaturës është bërë para dy vitesh. Studentët dhe personeli akademik mund të punojnë me fjalorët vetëm në bibliotekë dhe nuk mund ti marrin ato me vete. Orari zyrrar i bibliotekës është ora 08.00 e mëngjesit deri në orën 19.00 pasdite. Në rastet kur literatura përdoret jashtë ambienteve të bibliotekës, hapet një kartelë personale e cila përmban informacione të tilla si numrin e kartelës, emër, mbiemër, atësinë, adresën e banimit, numrin personal të identifikimit, numrin e telefonit, fakultetin,</p>

	<p>programin e studimit etj, si dhe nënshkrimin e përgjegjës të bibliotekës dhe lexuesit. Punonjësit e bibliotekës konfirmuan se nuk ka ndodhur ndonjëherë që studentët të mos kthejnë librat e marrë në bibliotekë.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit;</i></p> <p><i>Evidenca IV.14 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka disponon një fond të konsiderueshëm literature të huaj dhe shqipëtare, përkatësisht 620 tituj në dispozicion të programit të studimit gjuhë angleze. Përditësimi i fundit i literaturës është bërë para dy vitesh. Në bibliotekë gjenden kryesisht libra, fjalorë, enciklopedi, periodikë, manual ndërsa në bibliotekën online gjenden kryesisht botime, revista shkencore, por edhe libra dhe botime të ndryshme që i vijnë në ndihmë studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Përveç shërbimit në bibliotekë, personeli akademik dhe studentët mund të aksesojnë literaturë të huaj dhe shqiptare edhe online. Ky shërbim ofrohet nëpërmjet platformës ULibrary dhe është papagesë. Gjithashtu në ambientet e universitetit pajisjet elektronike mund të lidhen me WIFI e cili i jep mundësi studentëve dhe personelit akademik të punojnë në çdo ambient, brenda universitetit.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca IV.14.1 Biblioteka, Manuali i përdorimit</i> https://ulibrary.rash.al/ https://uogj.edu.al/biblioteka-online/</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Pas vizitës në UGJ rezultoi se biblioteka është e pajisur me kompjutera dhe pajisje të tjera teknike, që mund të përdoren nga studentët dhe personeli akademik.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit</i></p>

<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ pas vizitës në UGJ si edhe takimit me punonjësit e bibliotekës konstatoi se biblioteka është e hapur dhe në shërbim të punonjësve, personelit akademik dhe studentëve çdo ditë të javës, nga e hëna në të premte, në orarin e afishuar edhe në mjediset e institucionit. Nuk përfshihen këtu pushimet zyrtare. Orari i bibliotekës është ora 08.00 e mëngjesit deri në 19.00 e pasdites. Aksesit fizik në bibliotekë dhe tërheqja e librave realizohet nëpërmjet kartelave personale.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca IV.14.2 Rregullore e Bibliotekës;</i></p> <p><i>Evidenca IV.14 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Në takimin e zhvilluar në UGJ, punonjësit e bibliotekës deklaruan se biblioteka raporton mbi cilësinë e fondit fizik dhe online, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të sallave.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Biblioteka e UGJ vë në dispozicion të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze 620 tituj të huaj dhe shqip, ka një orar të përcaktuar dhe të afishuar në ambientet e universitetit. Biblioteka disponon kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme për të studiuar personeli akademik dhe studentët si edhe raporton mbi gjendjen e bibliotekës dhe bën kërkesë për pasurimin e saj me tituj të rinj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në universitetin e Gjirokastrës në zyrat e sekretarisë mësimore, u njoh me sistemin elektronik Pitagora i cili ofron lehtësira për administratën, sekretarinë dhe studentët. Nga ana tjetër, GVJ u njoh fizikisht me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike si edhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Këto regjistra ishin të plotësuar në të gjitha zërat e tyre sipas standardeve në fuqi. Lidhur me numrin e studentëve të regjistruar gjatë 3 viteve të fundit në këtë program studimi rezultoi se:</p> <p>në vitin akademik 2020-2021 ishin regjistruar 6 studentë;</p> <p>në vitin akademik 2021-2022 ishin regjistruar 5 studentë;</p> <p>në vitin akademik 2022-2023 ishin regjistruar 14 studentë; Gjithashtu u vu re se edhe në rast se studenti nuk e kishte frekuentuar lëndën, atij i jepej mundësia për të dhënë provimin në sezonin e vjeshtës. GVJ u njoh edhe me disa dosje të studentit të cilat rezultuan të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi. Suplementi i diplomës lëshohej në dy gjuhë dhe të dhënat në regjistër plotësohen nga personeli ndihmës akademik (sekretarja) në momentin e tërheqjes së diplomës.</p> <p>Gjithashtu, sekretaria mësimore konfirmoi se UGJ është pjesë e RASH dhe bashkëpunon me QSHA për realizimin e procesit të aplikimit, regjistrimit të kandidatëve dhe pajisjes së studentëve me numër matrikullimi. Sipas sekretarisë mësimore por edhe vetë personelit akademik, vlerësimi u njoftohet drejtëpërdrejtë studentit, fillimisht nga pedagogu, nëse nuk është njoftuar nga pedagogu studenti mund të njoftohet për vlerësimin në sekretarinë mësimore. Lidhur me sistemin Pitagora, GVJ u vendos në dijeni rreth disa problematikave në sistem të cilat pritet të rregullohen dhe të bëhet përditësimi i nevojshëm.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 44;</i></p>

	<p><i>Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4;</i></p> <p><i>Evidenca IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3;</i></p> <p>https://uoj.pitagora.rash.al/login;</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Menaxhimi, administrimi i informacionit dhe dokumentacionit, aktiviteti i personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe administrativ në universitetin e Gjirokastrës realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akadematike dhe Administrative, përkatësisht Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari Protokoll. Ky sektor manaxhon regjistrin themeltar, dosjet personale të punonjësve, librezat e punës së punonjësve si edhe çdo document tjetër. Nga ana tjetër, gjatë takimeve në UGJ, përfaqësuesja e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë shpjegoi sesi realizohet përditësimi dhe administrimi i bazës së të dhënave lidhur me kërkimin shkencor të personelit akademik. Ndër të tjera, mbështetur edhe në bazën ligjore në fuqi, në universitetin e Gjirokastrës ruhen dhe administrohen ngarkesa mësimore, programet mësimore, marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Nenet 3, 4, 5;</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 82</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave shoqërore, Neni 46;</i></p> <p><i>Evidenca IV.8 Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik;</i></p> <p><i>Evidenca IV.8.1 Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik;</i></p> <p><i>Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit Pitagora, personeli akademik dhe studentët që ndjekin Programin Bachelor në Gjuhë Angleze në Universitetin e Gjirokastrës, mund të marrin dhe ngarkojnë informacione të ndryshme si vlerësimi i studentëve, lëndët mësimore, sezonet e provimeve, oraret mësimore, procesverbale të provimeve. Në takimet e zhvilluara me personelin akademik dhe ndihmës akademik në UGJ, rezultoi se përveç sistemit Pitagora, informacione të tilla si, Rregullore e Programit, Plani Mësimor, Struktura Mësimore, publikohen edhe në faqjen zyrtare të internetit të universitetit.</p>

	<p>Evidenca</p> <p>https://uogj.pitagora.rash.al/login;</p> <p>https://uogj.edu.al/.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Platformat e përdorura në funksion të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit, shpërndarjes së materialeve didaktike mes personelit akademik, studentëve dhe personelit ndihmës akademik janë: sistemi Pitagora, Microsoft Office 365, Microsoft Teams, LearningKey. Për secilin prej këtyre platformave UGJ ka mundësuar për studentët dhe personelin akademik manuale përdorimi të cilat janë të publikuara dhe ofrojnë funksione të ndryshme si krijimi i kurrikulës, krijimi i detyrave të shtëpisë, platforma e testimit, klasë virtuale, programuesi i klasës, kalendari personal, menaxhimi i grupeve.</p> <p>Evidenca</p> <p>https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/;</p> <p><i>Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet;</i></p> <p><i>Evidenca III.5.1 TECOMP-Strategjia për përmirësimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Evidenca III.5.2 Vendim i SA-Tecom Strategjia për përmirësimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Evidenca IV.18 Urdhër për përdorimin e platformës Learning Key;</i></p> <p>http://www.tecomp.ni.ac.rs/; http://ëëë.tecomp.ni.ac.rs/doenload/LearningKey-Guideline_eng-1.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Përveç platformës Pitagora, kryesisht edhe në periudhën e Covid 19, janë përdorur edhe platforma të tjera si Microsoft Office 365, ESSE3, Microsoft Teams, Learning Key. Këto platforma i vijnë në ndihmë jo vetëm studentëve por garantojnë monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ dhe raportime.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët;</i></p> <p><i>Evidenca III.5.1 TECOMP-Strategjia për përmirësimin e cilësisë;</i></p>

<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare e Universitetit të Gjirokastrës është aktive dhe në të publikohen njoftime dhe informacione lidhur me programet e studimeve, njoftimet për punësim, njoftimet për shkëmbime, orari mësimor, kalendari i provimeve, struktura mësimore. Këto informacione janë të përkthyer edhe në gjuhën angleze. Megjithatë, të dhënat e publikuara duhet të përditësohen në mënyrë periodike.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 60</i></p> <p>http://uogj.edu.al/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se Universiteti i Gjirokastrës disponon sistem të brendshëm të menaxhimit dhe administrimit të dokumentacionit, informacionit dhe monitorimit akademik dhe financiar. Megjithatë, të dhënat e publikuara duhet të përditësohen në mënyrë periodike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Mbështetur në bazën ligjore në fuqi si edhe në statutin e UGJ, ky i fundit harton raporte financiare të kostove dhe mbështetjes financiare të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. Gjatë takimeve në universitet me përgjegjës të njësisë bazë dhe personelin akademik rezultoi se personelin akademik pyetet çdo vit rreth kërkesave financiare që ata mund të kenë lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe zhvillimit të aktivitetit kërkimor shkencor. Njësia bazë dhe njësia kryesore bëjnë propozimet dhe ia dërgojnë administratorit i cili bën edhe projekt buxhetin vjetor dhe më pas ky projekt miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik. Personeli akademik dhe drejtuesi i njësive kryesore dhe njësive bazë shprehën gjatë takimit se fondet janë të pakta kryesisht për mbështetjen e</p>

	<p>kërkimit shkencor. Duke qenë se numri i studentëve është ulur në krahasim me vitet e kaluara, të ardhurat e universitetit janë reduktuar ndjeshëm. Nga ana tjetër, ata deklaruan se një mënyrë tjetër që universiteti përdor për të gjeneruar të ardhura është nëpërmjet lëshimit të sallave me qira.</p> <p><i>Megjithatë, numri i aktiviteteve të tilla është i ulët dhe përkthyer në vlera financiare këto të ardhura janë shumë të vogla. Kjo është edhe arsyeja pse mbështetja financiare për kërkime shkencore është më e ulët se ajo e shumë viteve më përpara ku numri i studentëve ishte më i lartë.</i></p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 103;</i></p> <p><i>Evidenca IV.16 Propozim buxheti DGJH;</i></p> <p><i>Evidenca I.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër 2020-2025, Kreu Financat dhe Burimet Financiare, faqe 34;</i></p> <p><i>Evidenca IV.16.4 Projekt Buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023-2025;</i></p> <p><i>Evidenca IV.16.5 Kërkesë nga Administratori për projekt buxhetit afatmesëm 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të</p>	<p>Mbështetur në evidencat si më poshtë si edhe pas konfirmimit gjatë takimeve të zhvilluara nga GVJ në Universitetin e Gjirokastrës, rezultoi se plani i financimit institucional mbështetet në disa zëra si, financimi i burimeve njerëzore në kuadër të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për Bibliotekën, për pasurimin e literaturës së saj si dhe aksesin në bibliotekat online. Mbi këtë të fundit vlen të përmendet fakti se biblioteka pasurohet vazhdimisht me tituj. Pasurimi i bibliotekës realizohet pjesërisht nga buxheti dhe pjesërisht nga dhurime dhe donacione personale. Gjithashtu, në raportet vjetore parashikohen financime origjina e të cilave është Buxheti i Shtetit si edhe financim nga të ardhurat e institucionit. Zëra të evidentuar në raportet vjetore nga të ardhurat e institucionit përsfijnë, tarifat e shkollimit, vërtetime, listë notash, tarifë regjistrimi. Vlen të theksohet fakti se projektet janë të pakta në numër dhe se UGJ duhet të rrisë numrin e bashkëpunimeve me sektorë apo programe të cilat mund të ndihmojnë në rritjen e të ardhurave në UGJ.</p>

studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	<p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020;</i> <i>Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021;</i> <i>Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022;</i> <i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Lidhur me vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së financimit të Universitetit të Gjirokastrës, GVJ konstatoi se përgjegjëse është drejtoria e shërbimeve universitare. Mbështetur në legjislacionin në fuqi, kjo drejtori është përgjegjëse për raportimin financiar vjetor. Përveç këtij vlerësimi, UGJ është subjekt i auditit financiar të realizuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020;</i> <i>Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021;</i> <i>Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022;</i> <i>Evidenca IV.17 Raporti përfundimtar i KLSH-së për performancën e Universiteteve;</i> <i>Evidenca IV.17.1 Raport i MASR AUDIT 2018;</i> <i>Evidenca IV.17.2 Raport i MAS AUDIT 2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe Administratori i UGJ-së raportojnë për realizimin e buxhetit të miratuar në vitin paraardhës në Senatit akademik të UGJ-së dhe Bordin e Administrimit. Kjo është e qartë në raportet financiare ku një pjesë të mirë e zë shpjegimi i zërave për realizimin e shpenzimeve të domosdoshme si edhe parashikimi dhe realizimi i fondeve në total. Konkretisht në këto raportime vihet re shtjellimi dhe analizimi i shpërndarjes së fondeve nga buxheti i shtetit dhe nga të ardhurat dytësore. Raportet janë të firmosura dhe të vulosura nga administratori i universitetit dhe shoqërohen me anekse të detajuara.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020;</i> <i>Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021;</i> <i>Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022.</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Lidhur me qëndrueshmërinë financiare të universitetit, GVJ gjatë takimeve të zhvilluara në UGJ konstatoi se ajo garantohej nëpërmjet financimit të drejtëpërdrejtë nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të gjeneruara nga tarifat e studentëve, apo shërimet të tjera që ofron universiteti.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020;</i> <i>Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021;</i> <i>Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022;</i> <i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Lidhur me garantimin e financimit dhe mbështetjes financiare për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, GVJ shprehet se UGJ e garanton këtë mbështetje.</i></p> <p><i>Megjithatë GVJ sugjeron që UGJ të forcojë më shumë bashkëpunimin me aktorë të tretë në mënyrë që të garantojë më shumë financim për kërkimin shkencor dhe mbështetje financiare për personelin akademik kjo pasi, numri i aktiviteteve të tilla është i ulët dhe përkthyer në vlera financiare këto të ardhura janë shumë të vogla.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.

Mbështetur në takimet e zhvilluara në UGJ, rezultoi se ky i fundit zbaton politika dhe procedura ligjore të cilat mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve. Këto politika zbatohen që në momentin e regjistrimit të studentëve në universitet e deri në përfundim të studimeve. Sipas evidencave të vendosura në dispozicion, pranimet e studentëve bëhen me vendim të Senatit Akademik si edhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi. Konkretisht sipas shtojcës nr. 1 të urdhrin të përbashkët për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në IAL, pranimet e studentëve realizohen sipas tre raundeve. Gjithashtu, sipas rregullores së programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, vlen të theksohet fakti se kohëzgjatja normale e studimeve është tre vite akademike, se programi është i vlerësuar me 180 kredite mbështetur në standardet e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Faza përfundimtare e programit të studimit është diplomimi, i cili realizohet nëpërmjet një provimi të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome, si edhe lëshimi i diplomës universitare e titulluar Bachelor në Gjuhë Angleze. Synimi i këtij programi është të japë njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet lëndësh mësimore, gjuhësore dhe letrare. Kushtet e pranimit në këtë program studimi janë të specifikuara qartë në rregulloren e këtij programi dhe janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Rregullorat e ndjekjes së programit të studimit dhe procedurat e diplomimit janë të shtjelluara qartë dhe në detaje në rregulloren e programit, duke filluar nga format e zhvillimit të provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve, diplomimi dhe mikroteza, detyrimet e studentëve mbi pjesëmarrjen në mësim, procedurat dhe modalitetet e transferimit, dokumentacioni themelor shkollor, plani mësimor, programet mësimore, literatura, orari mësimor, vlerësimi i studentit, pasqyra e rezultateve, kohëzgjatja e provimeve, mundësitë e ankimimit, mbartja e provimeve ose riprovimi, etj. Gjithashtu, çdo vit nëpërmjet vendimeve të senatit akademik, UGJ miraton kriteret e pranimit për studentët e ciklit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Mastër i Shkencave. Vlen të theksohet fakti se, plani mësimor i këtij programi studimi është hartuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi, ku në semestrin e parë dhe të dytë mësimi shtrihet gjatë 15 javëve mësimore, se realizohen 2 provime në semestër (një provim i ndërmjetëm dhe një përfundimtar) dhe se programi mësimor finalizohet me punim diplome ose eprovim të përgjithshëm përfundimtar. Planu mësimor është i organizuar sipas



kategorisë A: Lëndët Bazë, kategorisë C: Lëndë Ndërdisciplinore, kategoria D: lëndë plotësuese, kategoria E: detyrime përmbyllëse. Së fundmi, por jo nga rëndësia, sipas edhe evidencës bashkëlidhur, diplomat e lëshuara nga UGJ për këtë program studimi përmbyllëse të gjithë elementët e parashikuara në aktet ligjore në fuqi si: numri i identifikimit, emri i studentit, emërtimi i diplomës, emërtimi i fakultetit i cili e lëshon diplomën, logon e UGJ si edhe stemën e Republikës së Shqipërisë, datën e mbrojtjes së temës, numrin e diplomës, numrin e matrikullimit, ID e maturës shtetërore, datën e lëshimit, emri dhe firma e dekanit dhe rektorit.

Evidenca

Evidenca II.11.3 Baza ligjore për pranimet-në-IAL;

Evidenca II.11.3 Baza ligjore QSHA dhe RASH për pranimet e reja; Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 62;

Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 49;

Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave shoqërore, Neni 17;

Evidenca I.9 Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, fq.4;

Evidenca V.1 Udhëzim-Nr.12-datë-30.6.2023-Për-procedurat-e-aplikimit-dhe-të-regjistrimit-në-IAL;

Evidenca V.1.1 Urdhër i përbashkët RASH dhe QSHA Nr 10 datë 10-07-2023, për miratimin e kalendarit 2023-2024;

Evidenca V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023-2024;

Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca II.13.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023;

Evidenca II.13 Vendim i Senatit Akademik për kriteret 2022-2023; Evidenca II. 13.3 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2022-2023;

Evidenca II.11 Vendim Senati Akademik për kuotat 2021-2022; Evidenca II.11.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2021-2022;

Evidenca II.11.2 Raporti i verifikimit të kapaciteteve pritëse 2021-2022;

Evidenca II.12.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2021-2022;

Evidenca II.12 Vendim SA për kriteret e pranimit 2021-2022;



	<p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Gjuhë Angleze 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, neni 15;</i></p> <p><i>Evidenca II.5 Model diplome Bachelor në Gjuhë Angleze.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret e pranimit të studentëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre si edhe parime të ndryshme, përfshirë edhe ato të barazisë, janë të parashikuara qartë në statutin e UGJ. Detaje të tjera lidhur me zbatimin e parimit të barazisë por edhe procedura specifike të cilat lehtësojnë ndjekjen e studimeve në këtë universitet, përfshirë transferimin e studimeve, njohjen e krediteve, alokimin e bursave, ofrimin e shanseve të barabarta, janë të parashikuara në rregullore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 65, pika 6 dhe KREU X;</i></p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave shoqërore;</i></p> <p><i>Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë;</i></p> <p><i>Evidenca V.3 Dosja personale e studentit nga hyrja deri në diplomim; Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve;</i></p> <p>https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/</p> <p>https://uogj.edu.al/statuti-i-universitetit/</p> <p>https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe</p>	<p>Lidhur me këtë kriter, mbështetur edhe në evidencat e vëna në dispozicion rezulton se, UGJ vendos kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve potencialë për të studiuar në këtë program. Këto kritere propozohen nga Njësia Bazë, përcillen në Rektorat dhe miratohen nga Senati Akademik. Një element i rëndësishëm në këtë kriter është zbatimi i legjislacionit në fuqi. UGJ i vendos kriteret mbështetur në bazën ligjore.</p> <p>Evidenca</p>

<p>udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p><i>Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca V.2.2 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2024-2025; Evidenca V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023 - 2024;</i></p> <p><i>Evidenca V.2.3 Vendim Senati Akademik për miratimin e kriterëve 2024-2025 dhe kuotave 2023-2024;</i></p> <p><i>Evidenca V.1.2 VKM Nr.436 për kriterin e mesatares;</i></p> <p><i>Evidenca V.1.3 VKM Nr.46 i kriterit të mesatares i përditësuar.</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Mbështetur në takimet e realizuara në UGJ, rezultoi se studentët njihen paraprakisht me kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes, transferimit të studimeve apo cdo shërbim tjetër. Sipas përfaqësuesve të studentëve dhe personelit ndihmës akademik, këto kriteret dhe procedura janë lehtësisht të aksesueshme nëpërmjet faqes ëeb të universitetit si edhe sekretarisë mësimore ose njoftimit publik të afishuar në vende lehtësisht të dukshme. Pranimi i studentëve realizohet sipas sistemit meritë-preferencë. Kriteret e përcaktuara dhe procedurat që ndiqen janë në mbështetje të bazës ligjore, rregullore së universitetit, njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Gjithashtu, në takime u konfirmua se kur studenti ka një mestare mbi notën 7, i shlyen detyrimet përmbyllëse me hartimin e temës dhe mbrojtjen e diplomës përpara një komisioni të posaçëm dhe nëse studenti ka një mestare nën notën 7, ai i shlyen detyrimet përmbyllëse duke zhvilluar provimin përmbyllës.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Kreu IV, Kreu V;</i></p> <p><i>Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Kreu IV;</i></p> <p>www.uogj.edu.al;</p> <p>https://uogj.pitagora.rash.al/login.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të</p>	<p>Informimi i palëve të interesuar për të njohur më shumë rreth kërkesave, kriterëve të përgjithshme apo të veçanta të regjistrimit apo transferimit të programeve të studimit apo çdo informacion tjetër, realizohet në forma të ndryshme. Këtu bëjnë pjesë, publikimi në faqen ëeb, informimi në rrjetet sociale, median lokale si edhe metoda klasike e shpërndarjes</p>

<p>veçanta të programit të studimit.</p>	<p>së fletëpalosjeve dhe posterave informues. Gjithashtu, gjatë takimeve rezultoi se universiteti merr pjesë në panairin e përvitshëm Work and study, ku çdo universitet, publik apo jopublik mund të promovojë programet e studimit dhe të njohë palët e interesuara mbi çdo pyetje lidhur me kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme të regjistrimit në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. Më parë, UGJ organizonte edhe ditë orientuese në shkolla të mesme.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022;</i></p> <p><i>Evidenca V.4 Kalendar i zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve;</i></p> <p><i>Evidenca V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantëve;</i></p> <p><i>Evidenca V.4.2 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e Open Day për informimin e maturantëve;</i></p> <p><i>Evidenca V.4.3 Fletëpalosje UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca V.4.4 Poster UGJ; http://uogj.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Mbështetur në dokumentet e miratur lidhur me parashikimin e kuotave të pranimit dhe kriterëve për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakicave dhe shtresave të marginalizuara, rezultoi se UGJ zbaton udhëzimet përkatëse për aplikimin dhe regjistrimin e tyre. Konkretisht, në kriteret e pranimit për ciklin e parë të studimeve UGJ parashikon se 50% të pikëve e zënë nota mesatare e përgjithshme aritmetike e tre viteve të shkollës së mesme+matura shtetërore dhe 50% pesha specifike sipas lëndëve të përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë. Gjithashtu kuotat e pranimit janë të pasqyruara qartë në formë tabelore ku përcaktohen kapacitetet pritëse (35), kuotat brenda vendit (20), kuotat për studentët që aplikojnë për program të dytë studimi (4), kuotat për transferimet (5), kuotat për studentët me statusin e jetimit (2), studentët që gëzojnë statusin romë dhe egjiptianë (1) dhe ata që vijnë nga trojet (4).</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023 - 2024;</i></p>

	<i>Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca V.1 Udhëzim-Nr.12-datë-30.6.2023-Për-procedurat-e-aplikimit-dhe-të-regjistrimit-në-IAL</i>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Përveç kuotave dhe kriterëve të parashikuara në kriterin 6, UGJ parashikon edhe kuota dhe kriteret për përzgjedhjen për kandidatët nga shtetet e tjera dhe kryesisht nga Republika e Kosovës si dhe nga trojet shqipfolëse të shteteve si Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë (Serbi) dhe shtetas të Huaj. Evidenca <i>Evidenca V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023 - 2024; Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca V.1 Udhëzim-Nr.12-datë-30.6.2023-Për-procedurat-e-aplikimit-dhe-të-regjistrimit-në-IAL</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UGJ harton politika të veçanta për shtresat në nevojë, duke ofruar bursa shkollimi ose facilitate të tjera për këta studentë. Këto politika hartohen dhe miratohen në mbështetje të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi. Evidenca <i>Evidenca II.14 Vendime Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; Evidenca II.14.4 Vendim Senati Akademik për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë; Evidenca II.14.5 Vendim Bordi i Administrimit për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se studentët informohen në fillim të vitit akademik për mënyrën e vlerësimit dhe udhëzohen nga njësitë përgjegjëse për kontrollin e njohurive të dijeve si dhe për mënyrën e punimit të diplomës. UGJ gjithashtu harton politika të veçanta për shtresat në nevojë dhe bën një shpërndarje të drejtë të kuotave për studentët e rinj, studentët që duan të transefrohen, studentët që vijnë nga trojet ose studentët nga shtresat në nevojë. GVJ konstatoi gjithashtu se UGJ merr pjesë në panairin Eork and Study për të promovuar programet e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Mbështetur në takimet e zhvilluara në UGJ si edhe në dokumentet e dorëzuara, rezulton se sekretaria mësimore luan një rol të rëndësishëm në procesin e informimit të studentit për përparimin e tij akademik. Gjithashtu, jo vetëm sekretaria mësimore por edhe vetë personeli akademik është në komunikim të vazhdueshëm me studentët për ti informuar ato mbi përparimin e tyre akademik. Në fillim të vitit akademik studentët njihen me karakteristikat e programit të studimit, syllabusin, planin mësimor, procesin mësimor, orarin, strukturën. Këto informacione publikohen edhe në ambientet e universitetit, për të qenë më i lehtë aksesimi për çdo student. Vlen të theksohet edhe fakti se, procedurat e pranimit dhe të kalimit nga një vit akademik në tjetrin, janë të përcaktuara në rregulloren e UGJ.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VI, VII;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Kreu V, VI, VII;</i></p> <p><i>Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Kreu IV https://uogj.edu.al/.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Gjatë takimeve të realizuara në UGJ, rezultoi se ky i fundit nëpërmjet zyrave përkatëse, informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve nga studimet e mëparshme. Këto kritere dhe procedura janë edhe të pasqyruara në rregulloren e fakultetit. Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme. Informacion më i detajuar, sidomos në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm, merret pranë sekretarisë mësimore dhe nëpërmjet shpalljes së njoftimeve në stendat e informimit në UGJ. Procedura e njohjes dhe ekuivalentimit të lëndëve mësimore nga programi i mëparshëm i studimit në programin e studimit në UGJ kryhet</p>

	<p>nga Komisioni i njohjeve dhe ekuivalentimit të lëndëve mësimore, i ngritur pranë DGJH-së.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 72 Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 65;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Nenet 30, 31;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, fq. 8, 15, 16;</i></p> <p><i>Evidenca V.5 Ekuivalentim lëndesh mësimore Gjuhë Angleze; Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ pasi realizoi takimin në UGJ si edhe shqyrtoi dokumentacionin e dërguar, konstatoi se vlerësimi me notë dhe me pikë janë të parashikuara në syllabus dhe studenti njoftohet paraprakisht mbi mënyrën e vlerësimit. Kjo gjë u theksua edhe në takimin me studentët ku këta të fundit pranuan se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, është i gatshëm të ndihmojë studentët dhe se që në orën e parë të mësimit për çdo lëndë bëjnë të qarta procedurat e vlerësimit të dijeve. Specifika të tjera në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit, sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimin e provimeve, komisionet e provimeve, zhvillimin e provimeve, shpalljen e rezultateve, ankimimin dhe përmirësimin e notës, janë të parashikuara në rregulloren e universitetit, në rregulloren e studimeve, në rregulloren e fakultetit dhe departamentit. Nga takimi me studentët e këtij universiteti u pohua se ata njoftohen paraprakisht dhe se kur ka qenë e nevojshme personeli akademik dhe ndihmës akademik ka qenë i gatshëm ti informojë ato.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VI, VII;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Kreu VI;</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p><i>Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Kreu VI.</i></p> <p>GVJ vlerësoi se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit janë të përcaktuara në Rregulloren e UGJ rregulloren e fakultetit, rregulloren e njësisë bazë dhe rregulloren e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. Studentët në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome, në varësi të notës mesatare të studentit. Vlen të theksohet fakti se departamenti, në fillim të vitit akademik vë në dispozicion të studentëve çdo informacion apo material të nevojshëm në funksion të punimit të diplomës. Sipas rregullores së programit të studimit, mbrojtja e një tezë diplome realizohet nëse studenti arrin një mesatare mbi 8 gjatë dy viteve të studimit. Në fillim të semestrit të parë të vitit të tretë studentit zgjedh udhëheqësin dhe së bashku përcaktojnë temën mbi të cilën do të punojë studentit. Sipas rregullores, udhëheqësi është anëtar i personelit akademik të departamentit që organizon programin ose i ndonjë departamenti tjetër bashkëpunëtor. Është pikërisht këshilli i departamentit i cili bën aprovimin e temës së diplomës dhe udhëheqësit përkatës. Komisioni me tre anëtarë për mbrojtjen e temës së diplomës ngrihet nga përgjegjësi i departamentit, me miratim të dekanit të FESHSH. Pasi temat e diplomës përcillen në sekretarinë mësimore , përcaktohen edhe datat e mbrojtjes së tyre.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenet 59, 60, 61, 62, 63, dhe 64;</i></p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenin 93;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, fq. 14;</i></p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Gjuhë Angleze 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 59, pika 3;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, fq 7;</i></p> <p><i>Evidenca III.11.1. Miratimi i fushave të studimit;</i></p>
--	--



	<p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 61;</i></p> <p><i>Evidenca III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve;</i></p> <p><i>Evidenca III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në "Gjuhë Angleze".</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>UGJ merr pjesë në panairin ëork and study, për të promovuar programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, si edhe për të informuar çdo student rreth kriterëve apo procedurave të regjistrimit. Përveç pjesëmarrjes në këtë panair, UGJ përgatit fletëpalosje, postera si edhe spote televizive për të promovuar këtë program studimi.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panairin Ëork and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Ëork and Study 2023; Evidenca V.4 Kalendar i zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve;</i></p> <p><i>Evidenca V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantëve;</i></p> <p><i>Evidenca V.4.2 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e Open Day për informimin e maturantëve;</i></p> <p><i>Evidenca V.4.3 Fletëpalosje Universiteti;</i></p> <p><i>Evidenca V.4.4 Poster UGJ.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>UGJ vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, Bachelor në Gjuhë Angleze, në fillim të vitit akademik, informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimit përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.</p> <p>Studentët informohen që në hyrje për mënyrën e vlerësimit dhe udhëzohen nga njësitë përgjegjëse për kontrollin e njohurive të dijeve si dhe për mënyrën e punimit të diplomës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët e UGJ informohen mbi strukturën dhe kohëzgjatjen e studimeve në forma të ndryshme. Sekretaria mësimore, faqja ëeb si edhe personeli akademik i vijnë në ndihmë studentëve për tu informuar rreth programit apo për çdo ndryshim të nevojshëm.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë;</i></p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI, VII;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, Kreu II</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Në fillim të çdo vit akademik, kryesisht gjatë javës së parë të mësimin, studentët marrin informacion nga personeli akademik mbi programin e lëndës ku përcaktohen qartë temat dhe shpërndarja e tyre përgjatë semestrit, periudha e provimeve, objektivat formues, mënyra e vlerësimit etj.</p> <p>Kjo gjë është pasqyruar në RVB por u konfirmua edhe përgjatë takimeve me personelin akademik të këtij programi studimi dhe përgjatë takimeve me studentët e po këtij programi.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca V.3.1 Udhërrëfyes për studentët;</i></p> <p><i>Evidenca V.3.2 Vendim Senati për udhërrëfyes për studentët;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Angleze;</i></p> <p><i>Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Gjuhë Angleze 2021-2022; Evidenca II.30 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze 2022-2023;</i></p> <p>www.uogj.edu.al</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në aspekt të vlerësimit të mundësive të punësimit si edhe mbështetjes intitutionale të studentit, pranë UGJ janë ngritur zyra e këshillimit të karrierës, zyra e Alumni dhe e Vlerësimit të Vazhduar. Këto struktura shërbejnë si urë lidhëse mes studentëve dhe tregut të punës. Studentët mund të paraqiten pranë këtyre zyrave për të marrë një orientim të drejtë mbi karrerën e tyre ose për tu informuar mbi vendet vakante apo</p>



	<p>pozicione pune të cilat mund ti konsiderojnë të përshtatshme për profilin e tyre. Shpesh herë këto zyra krijojnë kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. Ka raste edhe kur ish studentë të UGJ, tashmë të suksesshëm realizojnë orë të hapura, motivuese për të nxitur studentët të punojnë më shumë në fushën e tyre.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panairin Eork and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Eork and Study 2023;</i></p> <p><i>Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 14;</i></p> <p><i>Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Tabela 23. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve;</i></p> <p><i>Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Që në javën e parë të mësimit që është edhe java e orientimit për studentët e vitit të parë, studentët informohen edhe për ambientet dhe infrastrukturën e Njesisë Kryesore që është në dispozicion të studentëve përgjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre. Megjithatë, gjatë dy viteve të fundit sistemi Pitagora ka hasur problematika teknike dhe për këtë arsye nuk ka qenë gjithmonë i aksesueshëm për studentët në mënyrë që ata të njihen me sallat, orarin, vlerësimin për lëndë, etj. Sekretaria mësimore, faqja zyrtare ëeb, njoftimi përmes postës zyrtare elektronike apo njoftimet në rrjetet sociale janë disa mënyra të tjera të informimit të studentëve.</p> <p>Evidenca</p> <p>https://uogj.pitagora.rash.al/login;</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, GVJ konstaton se informacioni gjendet në faqen e UGJ dhe si rrjedhojë, ky informacion është i aksesueshëm edhe në distancë.</p> <p><i>Nga ana tjetër, sistemi Pitagora ka nevojë të mirëmbahet dhe përditësohet vazhdimisht. Informacioni në lidhje me programin e studimit u ofrohet studentëve personalisht me komunikim të drejtpërdrejtë nga sekretaria mësimore.</i></p> <p>Evidenca</p>

	www.uogj.edu.al ; https://uogj.pitagora.rash.al/login .			
Konkluzione	<p>GVJ konstatoi se nëpërmjet faqes web të UGJ, studenti mund të gjejë informacionin e dëshiruar. Ky informacion është i aksesueshëm edhe në distancë. Sekretaria mwsimore dhe personeli akademik i vijnë në ndihmë studentëve për tu informuar rreth programit apo për çdo ndryshim të nevojshëm. Megjithatë, GVJ konstatoi se gjatë dy viteve të fundit sistemi Pitagora ka hasur problematika teknike dhe për këtë arsye nuk ka qenë gjithmonë i aksesueshëm për studentët në mënyrë që ata të njihen me sallat, orarin, vlerësimin për lëndë. Pwr sa mw sipwr, <u>sugjerohet</u> që sistemi Pitagora ti nënshtrohet përditësimeve të nevojshme për mbarëvajtjen e tij.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>UGJ mban një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në këtë program studimi. Në sekretarinë mësimore ruhet dokumentacioni i procesit mësimor konkretisht regjistri themeltar i studentëve, regjistri i arritjeve akademike dhe regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Specialisti i Statistikës në bashkëpunim me Sekretarinë mësimore mbledh, përpunon, ruan dhe paraqet informacione statistikore. Gjithashtu GVJ u informua se UGJ gjurmon studentët e diplomuar dhe harton një listë mbi punësimin e tyre ose gjendjen e tyre aktuale në momentin e komunikimit. Departamenti përgatit çdo vit analizën mësimore në të cilën janë të pasqyruara statistikat vjetore në lidhje me numrin e të diplomuarve në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. Ky informacion ruhet në departament së bashku me shumë të dhëna të tjera në lidhje me studentët.</p>

	<p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 92;</i></p> <p><i>Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Tabela 21. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve;</i></p> <p><i>Evidenca V.6 Raport statistikor student-pedagog për çdo fakultet; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Të dhënat e parashikuara në këtë kriter përpunohen dhe ruhen në të dy formatet, si atë elektronik edhe në atë fizik. Lidhur me numrin e studentëve të regjistruar gjatë 3 viteve të fundit në këtë program studimi rezultoi;</p> <ul style="list-style-type: none"> - në vitin akademik 2020-2021 ishin regjistruar 6 studentë; - në vitin akademik 2021-2022 ishin regjistruar 5 studentë; - në vitin akademik 2022-2023 ishin regjistruar 14 studentë; <p>Për më tepër, sekretaria mësimore mban dosje për çdo student duke dokumentuar çdo të dhënë që nga momenti i regjistrimit deri në atë të diplomimit. Dosjet e studentëve me të cilat u njoh GVJ ishin të plota dhe përmbanin të gjithë elementët sipas parashikimeve ligjore.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2018-2019;</i></p> <p><i>Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.11.6 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabela 21. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve;</i></p> <p><i>Evidenca V.14 Lista e të transferuave dhe të larguarve nga UGJ.</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht</p>	<p>Informacioni i grumbulluar për çdo student ruhet në mënyrë konfidenciale dhe mund të jetë i aksesueshëm vetëm për persona të autorizuar duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen jo vetëm manualisht por edhe elektronikisht.</p>

<p>të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 92, pika 3;</i></p> <p><i>Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Në UGJ, kontrolli periodik i dokumentacionit realizohet pranë njësisë bazë, njësisë kryesore dhe sekretarisë mësimore. Këto struktura vlerësojnë dhe dokumentojnë gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca V.7 Kontroll dokumentacioni viti akademik 2018-2019;</i></p> <p><i>Evidenca V.7.1 Kontroll dokumentacioni viti akademik 2020-2021;</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Njësia kryesore dhe njësia bazë hartojnë raporte të përvitshme në lidhje me ecurinë e procesit mësimor. Në Raportin Vjetor Institucional përfshihen veprimtaria mësimore dhe shkencore, ecuria e programeve të studimit, informacione për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Sipas evidencave bashkëlidhur, UGJ harton një listë të studentëve të cilët kanë përfunduar studimet pranë këtij universiteti dhe i gjurmon ato vazhdimisht për tu informuar lidhur me punësimin e tyre. Megjithatë, në tabelën e gjeneruar nga zyra Alumni nuk specifikohet profili në të cilën janë punësuar studentët. Është e rëndësishme që pas përfundimit të studimeve, studentët të mund të punësohen në profilin në të cilin kanë përfunduar. Gjithashtu, sikurse parashikohet edhe në evidencat më poshtë, raportet vjetore të veprimtarisë mësimore, shkencore dhe financiare pasqyrojnë një informacion të detajuar mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarisë krijuese dhe inovacionit.</p>
	<p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2018-2019;</i></p>

	<p><i>Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.11.6 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Tabela 21. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Tabela 23. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Lidhur me cilësinë në hyrje dhe punësimin e studentëve të këtij programi studimi, GVJ konfirmon se UGJ e përmbush këtë standard plotësisht. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen dhe ruhen në mënyrë konfidenciale. Ky informacion mund të jetë i aksesueshëm vetëm për persona të autorizuar duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi. Zyra Alumni mban evidenca lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar panë këtij universiteti. Megjithatë <u>sugjerohet</u> që zyra Alumni të bëjë një përditësim të tabelës statistikore mbi të dhënat e punësimit të studentëve duke specifikuar edhe profilin në të cilin janë punësuar pas përfundimit të studimeve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Mbështetur në takimin e realizuar në UGJ me studentët por edhe në informacionin e përcjellë nëpërmjet RVB, GVJ konstatoi se, studentët e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze kanë përfaqësuesit e tyre në çdo organ vendimmarrës në universitet. Ata janë anëtarë me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik, në komisionet zgjedhore në nivel institucional dhe njësie kryesore, në komisione të përhershme si ajo e njësisë së sigurimit të cilësisë, në Këshillin e Etikës etj. Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse të institucionit,

	<p>realizohet në mbështetje të ligjit për arsimin e lartë, Statutit të UGJ dhe Rregullores së këtij universiteti.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 88, pika 1 gërma b, f, Neni 91;</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 18, pikat 2, 3;</i></p> <p><i>Evidenca II.1.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik;</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 24, pika 3;</i></p> <p><i>Evidenca V.8 Rregullore e organizimit të zgjedhjeve për Këshillin Studentor;</i></p> <p><i>Evidenca V.8.1 Anëtarët e Keëhillit Studentor UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca II.25 Statuti i Këshillit Studentor;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Tabela 24. Të dhëna për anëtarët e NJBSC;</i></p> <p><i>Evidenca V.9 Statuti i shoqatës sportive UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca V.11 Kërkesë për mbështetje financiare për shoqatën sportive studentore.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Mbështetur në takimet e realizuara me studentët në UGJ, rezultoi se UGJ garanton përfshirjen e studentëve ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. Në Senatit akademik studentët përfaqësohen në masën 10%. Studentët në këto takime janë aktiv duke shprehur mendimin e tyre mbi problematika të ndryshme të cilat mund ti prekin në mënyrë të drejtëpërdrejtë në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ata bëjnë propozime si edhe marrin pjesë në procese të rëndësishme vendimmarrjeje, duke qenë anëtarë të komisioneve zgjedhore institucionale. Gjithashtu, studentët organizohen në këshilla studentorë, janë anëtarë të GVB për akreditim, janë të përfaqësuar në Këshillin e Etikës. Megjithatë, përvec raporteve vjetore të UGJ nuk ka një raportim specifik nga NJSBC mbi sondazhet e organizuar nga UGJ ku studentët shprehen mbi vlerësimin e procesit akademik apo vlerësimin institucional. Nga evidencat e vëna në dispozicion nga UGJ nuk rezultojnë të jenë organizuar pyetësorë lidhur me vlerësimin e procesit mësimor nga ana e studentëve.</p> <p>Evidenca</p>

	<p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 88, pika 1 gërma b, Neni 91, pika 5;</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 18, pikat 2, 3;</i></p> <p><i>Evidenca II.1.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik;</i></p> <p><i>Evidenca V.12 Rregullore e zgjedhjeve të 2020;</i></p> <p><i>Evidenca V.12.1 Vendimet e KIZ;</i></p> <p><i>Evidenca II.25 Statuti i Këshillit Studentor;</i></p> <p><i>Evidenca V.10 Vendimi për ngritjen e GVB të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze;</i></p> <p><i>Evidenca V.10.1 Vendim Senati për miratimin e GVB për programet e studimit;</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 24, pika 3;</i></p> <p><i>Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës;</i></p> <p><i>Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Tabela 24. Të dhëna për anëtarët e NJBSC.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Mbështetur në takimet me studentët në UGJ, rezultoi se këto të fundit vazhdimisht pyeten lidhur me cilësinë e procesit mësimor. Sekretaria mësimore si edhe personeli akademik janë në komunikim të vazhdueshëm me studentët për ti dëgjuar ato rreth sugjerimeve që mund të kenë mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor, përditësimit të literaturës dhe bashkëpunimeve student – pedagog. Këto sugjerime reflektohen në mbledhjet e zhvilluara me përfaqësuesit e studentëve dhe të strukturave kompetente, në kuadër të përmirësimit të procesit të mësimdhënies, në programin e studimit bachelor në gjuhë angleze.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë, sikurse edhe universitetet e tjera, UGJ u gjend përpara gjendjes së jashtëzakonshme ku edhe procesi i mësimdhënies u komplikua, si për personelin akademik edhe për studentët. Në përfundim të gjendjes së jashtëzakonshme dhe kthimit në normalitet, UGJ hartoi pyetësorë të cilët ia drejtoi studentëve, ku parashikoheshin pyetje të ndryshme lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor gjatë periudhës së pandemisë. Këto pyetësorë dhe rezultatet e tyre janë reflektuar edhe në raportin vjetor të UGJ. Pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme NJSBC nuk ka organizuar pyetësorë periodikë me studentët për të bërë një vlerësim objektiv të procesit të mësimdhënies nga ana e studentëve.</p>

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	E	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, PROGRAMIT TË STUDIMIT	I				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT					X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTU RA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT					X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE					X
VI. SIGURIMI CILËSISË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR	I			X	
VLERËSIMI TËRËSOR					X



6. A more stable cooperation with third parties or the organization of various activities is recommended to guarantee the increase of funds for teaching and scientific research.

7. For diploma and course assignments, EEG recommends that the institution invest in providing an anti-plagiarism program. Also, it is suggested to expand the library fund with a wider range of contemporary English language books and scientific journals for the Bachelor study program in "English Language".



1. It is noted that the Internal Quality Assurance Unit does not design enough instruments for monitoring the teaching and scientific research process or annual work plans related to the organization and processing of data generated by these periodic questionnaires. (Standard VI.1, Criterion 2; Standard VI.2, Criterion 4; Standard VI.3, Criterion 3; Standard VI.5, Criterion 3).
2. It is established that the funding in the service of the program and the qualification of the academic staff is not sufficient and that the commitment of the academic staff of the department in research projects of the institution is low. (Standard IV.1 Criterion 6; Standard IV.5, Criterion 2).
3. It is established that the UGJ library lacks contemporary titles and publications (books) in English for the subjects and the program. The mandatory and supplementary literature across all program subjects has not been updated to include recent publications; (Standard II.4, criterion 5; Standard IV.3, criterion 1).
4. The absence of physical books related to the study program in the library poses a challenge; (Standard IV.3, criterion 4).

Recommendation

1. EEG recommends that the relevant structures for quality assurance at the University of Gjirokastra cooperate with the main unit and the basic unit within the framework of monitoring the teaching and scientific research process and, as a result, improving the safety of these processes. The tasks are clearly defined in the statute and internal regulations of the university, but the activities within them should be expanded.
2. The Internal Quality Assurance Unit is suggested to increase cooperation with the basic unit in order to increase the number of academic staff trainings. The focus of the training should be to inform the academic staff on quality standards, academic obligations, completion of syllabi, etc. Thus, the core unit and the quality assurance unit will increase the levels of teaching and research improvement in the English Language Bachelor study program.
3. The website of the institution is suggested to be periodically updated with information, for students, academic staff and academic assistants as well as for interested third parties and to guarantee the full functioning of the Pitagora system.
4. The academic staff of the program is suggested to engage in more scientific research projects. In this way, the income from scientific research in this department will increase.
5. As the demands in the national and international market for English language professionals are constantly increasing, the curriculum of the program is suggested to be constantly changing to adapt to the competencies required by the labor market.



6. Rekomandohet një bashkëpunim më i qëndrueshëm me palët e treta apo organizimin e aktiviteteve të ndryshme për të garantuar rritjen e fondeve për mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

7. Për punimet e diplomës dhe detyrave të kursit GVJ rekomandon që institucioni të investojë në sigurimin e një programi antiplagjaturë. Gjithashtu, sugjerohet zgjerimi i fondit të bibliotekës me një gamë më të gjerë librash e revistash shkencore në gjuhën angleze, bashkëkohore, për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë angleze".

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "English Language" provided by the Higher Education Institution "University of Gjirokastra Egerem Çabej"

Strengths and affirmations

1. The Bachelor study program in "English Language" is in accordance with the mission, the strategy of the institution, the academic field of the department and the needs of the market. The Foreign Languages Department reviews and updates the curricula based on the legislation in force and relevant documents. The program guarantees the preparation of students in accordance with the defined objectives.

2. The drafting and use of legal documentation at the institutional and program level (UGJ Statute, UGJ Regulations, FESHSH Regulations, Foreign Languages Department Regulations, etc.), testify to an institutionalized, structured and standardized activity. The creation of a complete structure, coordination and quality assurance units have helped in a more effective management, delegation of tasks and their better fulfillment.

3. The leaders of the main unit and the basic unit, as well as the academic staff, are committed to adapting this study program to the labor market, as well as trying to guarantee the standards and quality of the teaching process and scientific research, according to legal provisions.

4. The main unit and the base unit are ensured to be in constant communication with the academic staff and students as well as to come to their aid whenever necessary.

5. Through the agreements that the institution has with international universities, it offers opportunities to students to participate in mobility. Also, the institution serves as a bridge between students and the labor market, guaranteeing them internships and career counseling.

6. The program is offered in English, which has a direct impact on the development of students' language skills, as well as the highest possibility to easily integrate into the labor market.

Weaknesses



pune lidhur me organizimin dhe përpunimin e të dhënave të gjeneruara nga këto pyetësorëm periodik. (Standarti VI.1, Kriteri 2; Standarti VI.2, Kriteri 4; Standarti VI.3, Kriteri 3; Standarti VI.5, Kriteri 3).

2. Konstatohet se financimi në shërbim të programit dhe kualifikimit të stafit akademik nuk është i mjaftueshëm dhe se angazhimi i stafit akademik të departamentit në projekte kërkimore të institucionit është i ulët. (Standarti IV.1 Kriteri 6; Standarti IV.5, Kriteri 2).

3. Konstatohet se në bibliotekën e UGJ mungojnë tituj dhe botime bashkëkohore. Literatura e detyrueshme dhe ajo ndihmëse nuk është e përditësuar me literaturë të viteve të fundit në të gjitha lëndët e programit ; (Standarti II.4, kriteri 5; Standarti IV.3, kriteri 1).

4. Konstatohet mungesë e librave fizikë për lëndët e programit të studimit në bibliotekë; (Standarti IV.3, kriteri 4).

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon që strukturat përkatëse për garantimin e cilësisë në Universitetin e Gjirokastrës, të bashkëpunojë me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në kuadër të monitorimit të procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor e për pasojë, përmirësimin e sigurisë së këtyre proceseve. Detyrat janë të përcaktuara qartë në statut dhe rregullore të brendshme të universitetit, por aktivitetet në kuadër të tyre duhet të zgjerohen.

2. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë sugjerohet të rrisë bashkëpunimin me njësinë bazë në mënyrë që të rritet numri i trajnimeve të personelit akademik. Fokusi i trajnimeve të jetë informimi i personelit akademik mbi standardet e cilësisë, detyrimeve akademike, plotësimin e syllabuseve, etj. Kështu, njësia bazë dhe ajo e sigurimit të cilësisë, do të rrisin nivelet e përmirësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze.

3. Faqja web e insitucionit sugjerohet të përditësohet në mënyrë periodike me informacion, për studentët, personelin akademik dhe ndihmës akademik si edhe për palët e treta të interesuar dhe të garantohet funksionimi i plotë i sistemit Pitagora.

4. Stafi akademik i programit sugjerohet të angazhohet në më shumë projekte kërkimore shkencore. Në këtë mënyrë të ardhurat nga kërkimi shkencor në këtë departament do të rriten.

5. Duke qenë se kërkesat në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar për profesionistë të gjuhës angleze janë vazhdimisht në rritje, kurrikula e programit sugjerohet të jetë në ndryshim konstant për t'ju përshtatur kompetencave që kërkon tregu i punës.

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Angleze” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Gjirokastrës Egerem Çabej”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është në përputhje me misionin, strategjinë e institucionit, fushën akademike të departamentit dhe nevojat e tregut. Departamenti i Gjuhëve të Huaja kryen rishikimin e përditësimin e kurrikulave mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe dokumentat përkatëse. Programi garanton përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat e përcaktuara.
2. Hartimi dhe përdorimi i një dokumentacioni ligjor në nivel institucional dhe të programit (Statuti UGJ, Rregullore UGJ, Rregullore FESHSH, Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, etj), dëshmojnë për një veprimtari të institucionalizuar, të strukturuar dhe të standardizuar. Krijimi i një strukture të kompletuar, i njësive koordinuese dhe sigurimit të cilësisë kanë ndihmuar në një menaxhim më të efektshëm, delegim të detyrave dhe përmbushje më të mirë të tyre.
3. Drejtuesit e njësive kryesore dhe njësive bazë si edhe personeli akademik, janë të përkushtuar për ta përshtatur këtë program studimi me tregun e punës si edhe përpiqen për të garantuar standardet dhe cilësinë e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor, sipas parashikimeve ligjore.
4. Njësia kryesore dhe njësia bazë sigurohet të jetë në komunikim të vazhdueshëm me personelin akademik dhe studentët si edhe tu vijë në ndihmë atyre, sa herë që është e nevojshme.
5. Nëpërmjet marrëveshjeve që institucioni ka me universitete ndërkombëtare, u ofron mundësi studentëve për të marrë pjesë në mobilitete. Gjithashtu, institucioni shërben si një urë lidhëse mes studentëve dhe tregut të punës duke u garantuar atyre intershipe dhe këshillim për karrierën.
6. Programi ofrohet në gjuhën angleze që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e kompetencave gjuhësore të studentëve si dhe mundësinë më të lartë për tu integruar lehtësisht në tregun e punës.

Pika të dobëta:

1. Kontatohet se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nuk harton mjaftueshëm instrumenta monitorimit të procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor apo plane vjetore



			X	
--	--	--	----------	--

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




<p>monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>raporteve është evidentimi i problematikave dhe përmirësimi i procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Megjithatë, gjatë takimit të zhvilluar në UGJ me përfaqësuesit e NJBSC, <i>GVJ sugjeroi zhvillimin e më shumë pyetësorëve, hartimin e pyetësorëve të detajuar lidhur me këto dy çështje shumë të rëndësishme për përmirësimin e procesit mësimor apo sigurimin e cilësisë së tij.</i></p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca VI.7.2 Analiza e pyetësorit për procesin e mësimit online; Evidenca VI.3 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca VI.3.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca VI.3.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara në UGJ, lidhur me këtë kriter <i>GVJ i sugjeroi</i> përfaqësuesve të NJBSC si edhe përgjegjësit të njësisë bazë një bashkëpunim më të ngushtë në hartimin e planit vjetor, në të cilën të parashikohen pika të përcaktuara qartë mbi monitorimin dhe garantimin e cilësisë për këtë program studimi. Këtu përfshihen hartimi i planit të monitorimeve të përbashkëta për personelin akademik, lëndë të caktuara, syllabus apo trajnimet që NJBSC organizon në këtë kuadër. Përveç takimeve të drejtëpërdrejta me studentët apo publikimin e rezultateve, njësia kryesore duhet të garantojë një përfshirë më të madhe të aktorëve kryesorë të këtij procesi.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca VI.6 Takime me studentët-Këshillimi i Karrierës</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>NJBSC dhe njësia bazë, duhet të bashkëpunojnë më shumë në hartimin e planit vjetor të punës, në hartimin e pyetësorëve për studentët si edhe në zhvillimin e procedurave të tjera të parashikuara në bazën ligjore si të domosdoshme për garantimin e një cilësie më të mirë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Megjithatë, GVJ vlerëson përpjekjet e njësisë bazë dhe NJBSC në kuadër të përmirësimit të cilësisë në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Mbështetur në takimet e zhvilluara në UGJ si edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se UGJ mbështetur në rregulloret dhe kodin e etikës publikon rezultatet dhe analizat e rezultateve të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies duke respektuar etikën profesionale akademike si edhe privatësinë e palëve të përfshira.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca VI.7.1 Organizimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca VI.2 Procedura për zhvillimin me sukses të Sondazhit Kombëtar të studentëve;</i></p> <p><i>Evidenca VI.7.2 Analiza e pyetësorit për procesin e mësimit online; Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës.</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Mbështetur në evidencat e vënë në dispozicion nga UGJ, GVJ konstatoi se procedura e analizës së vlerësimit të pyetësorëve për programin e studimit që ofron njësia bazë, miratohet me vendim të sentatit Akademik. Megjithatë, në mungesë të instrumentave të përdorur për vlerësimin e cilësisë, rezulton se nuk ka një analizë të mirëfilltë dhe të detajuar të gjetjeve nga pyetësorë ose monitorime. Këto gjetje do të duhet të pasqyrohen në raporte ku parashtrihen propozime të zgjidhjes së nevojave/problematikave të evidentuara të cilat mund të implementohen për të përmirësuar cilësinë e procesit mësimor. Për sa më sipër, përpilimi i planit të masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, është i cunguar dhe shumë i përgjithshëm.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.21 Vendim i Akreditimit Institucional periodik;</i></p> <p><i>Evidenca I.21.1 Plani i veprimit pas rekomandimeve të Bordit të Akreditimit;</i></p> <p><i>Evidenca VI.7.2 Analiza e pyetësorit për procesin e mësimit online; Evidenca I.11.6 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca I.12.6 Raporti vjetor Njësia Kryesore FESHSH 2021-2022; Evidenca I.13.3 Raport vjetor i Njesisë Bazë të Gjuhëve të Huaja 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të</p>	<p>Hartimi i raporteve të vlerësimit të brendshëm, është një indikator i vlerësimit periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore, për programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. Qëllimi i hartimit të këtyre</p>

dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Në këtë mënyrë, njësia bazë arrin të përmirësojë cilësinë e programit dhe u vjen në ndihmë studentëve për të patur një qasje më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për të shfrytëzuar mundësi punësimi apo internship-i.			
Konkluzione	<p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Eork and Study 2022;</i> <i>Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Eork and Study 2023</i></p> <p><i>Mbështetur në sa më sipër, GVJ thekson rëndësinë e bashkëpunimit me aktorët e tretë si edhe me vetë studentët si element kyç të garantimit të një programi studimi sa më cilësor. Për këtë arsye, GVJ sugjeron shtimin e bashkëpunimit të njësisë bazë me këto aktorë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Mbështetur në takimet e zhvilluara në UGJ si edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se universiteti harton rregullore të posacme për sigurimin e brendshëm e cilësisë, harton raporte dhe analiza vjetore për të pasqyruar këtë veprimtari, harton plane strategjike të punës, mekanizma kontrolluese dhe monitoriese të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore. Veprimtaria e UGJ bëhet transparente nëpërmjet publikimit në faqen eeb.</p> <p>Evidenca</p> <p>https://uogj.edu.al/transparenca/</p> <p><i>Evidenca VI.5 Vendim Senati akademik për miratimin e programit të transparencës 2021;</i> <i>Evidenca VI.5.1 Vendim Senati akademik për miratimin e programit të transparencës 2023, i rishikuar.</i></p>

<p>studentëve e programit të studimit.</p>	<p>duhet të realizohet nëpërmjet pyetësorëve të cilët pasqyrojnë një qëndrim të drejtë dhe të paanshëm të studentit, garantojnë përfshirjen e tij në procesin e vlerësimit dhe mbi të gjitha këto rezultate ti bëhen të njohura palëve të interesuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë (personelit akademik) për të bërë të mundur ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e situatës.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 28, pika 5;</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 94;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH;</i></p> <p><i>Evidenca I.7 Rregullore e Brendshme e Njesisë Bazë të Gjuhëve të Huaja;</i></p> <p><i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze;</i></p> <p><i>Evidenca VI.4 Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>Evidenca V.10 Vendimi për ngritjen e GVB të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze;</i></p> <p><i>Evidenca V.10.1 Vendim Senati për miratimin e GVB për programet e studimit;</i></p> <p><i>Evidenca VI.7.1 Organizimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca VI.2 Procedura për zhvillimin me sukses të Sondazhit Kombëtar të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Mbështetur në takimet e zhvilluara në UGJ si edhe në dokumentet e vëna në dispozicion, GVJ konstatoi se personeli akademik dhe administrativ respekton integritetin akademik, lirinë dhe etikën akademike si edhe është i kujdesshëm për të shmangur cdo formë diskriminimi apo pabarazie kundrejt studentëve apo vetë personelit.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës;</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i UGJ, neni 6.</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë</p>	<p>Mbështetur në takimet e zhvilluara në UGJ, GVJ konstatoi se njësia bazë merr pjesë në aktivitete promovuese dhe se vazhdimisht është në kontakt dhe bashkëpunon jo vetëm me maturantët dhe studentët por edhe me aktorë të tretë të cilët japin konsultime apo orjentime të vjera për përshtatjen e</p>




	<p><i>Evidenca I.14 Organograma e Universitetit Eqrem Çabej;</i> <i>Evidenca VI.4 Rregullore e NJSBC, neni 3;</i> <i>Evidenca VI.4.2 Anëtarët e NJSBC;</i> <i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 94, pika 2;</i> <i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 96, pika 2; Evidenca VI.4 Rregullore e NJSBC, neni 7, pika 2;</i> <i>Evidenca VI.4.2 Anëtarët e NJSBC;</i> <i>Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Eork and Study 2022;</i> <i>Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Eork and Study 2023.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Mbështetur në Rregulloren e njësisë bazë, rregulloren e organizimit dhe funksionimit të universitetit, rregulloren e NJSBC, statutin e universitetit si edhe në takimet e zhvilluara në UGJ, GVJ konstatoi se detyrat dhe përgjegjësitë e njësive, zyrave dhe individëve me qëllim sigurimin e cilësisë në këtë program studimi, janë të shprehura qartë dhe në mënyrë koncize. Në këto dokumenta janë të përcaktuara qartë rolet dhe detyrat e personelit akademik, stafit administrativ, studentëve, personelit ndihmës akademik dhe ndihmës administrativ.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 94;</i> <i>Evidenca VI.4 Rregullore e NJSBC;</i> <i>Evidenca I.2 Rregullore e brendshme e UGj-së;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FESHSH;</i> <i>Evidenca I.7 Rregullore e Brendshme e Njesisë Bazë të Gjuhëve të Huaja;</i> <i>Evidenca I.9 Rregullore e Programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe</p>	<p>Mbështetur në statutin e UGJ, rregulloren e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, rregulloren e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, rregulloren e NJSBC, GVJ konstatoi se njësia bazë është përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit, ndaj ajo bashkëpunon me të gjitha strukturat e tjera në UGJ për të garantuar cilësinë e programit të studimit. Megjithatë, edhe pse të mirëshkruara në rregullore, këto standarde duhet të garantohen nëpërmjet veprimeve konkrete të cilat relizojnë një vlerësim objektiv të sigurimit të cilësisë. Monitorimi i procesit të mësimdhënies</p>

	<p>të posaçme për monitorimin dhe vlerësimin e programit të studimit në mënyrë periodike, periodiciteti nuk aplikohet. NJSBC nuk punon sipas një plani vjetor pune, por e shtrin aktivitetin e saj në kuadër të orëve të dedikuara të hapura. Gjithashtu mbledhja e të dhënave të nevojshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit, vështirësohet, pasi mbetet atribut i analizave vjetore të njëjësive. Institucioni nuk ka të dhëna mbi vlerësimin e programit nga studentët e diplomuar.</p> <p>Për sa më lart, GVJ vlerëson së ky standard, plotësohet kryesisht.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara në UGJ me studentët, përgjegjësia e departamentit dhe personelin akademik, GVJ konstatoi se njësia bazë e konsideron të rëndësishëm angazhimin e studentëve si edhe partnerëve në tregun e punës. Nga përgjigjet e të dy palëve u vu re se studentët ndihen të përfaqësuar si edhe që ata i njihnin njësitë e tjera përveç asaj bazë. Gjithashtu në takime u theksua edhe rëndësia e partnerëve të tretë të cilët janë një urë lidhëse mes universitetit dhe tregut të punës. Shpeshherë konsulta me këto partner sjell benefite për studentët duke e përshtatur programin e studimit me kërkesat e tregut të punës. Për më tepër, për të realizuar përmirësimin e programit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës, Zyra e Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar merr pjesë në evente të ndryshme promovuese për programin e studimit, me qëllim rritjen e bashkëpunimit me maturantët, studentët dhe aktorë të tretë, duke u konsultuar me to rreth praktikave më të mira që mund të implementohen.</p>
	<p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 93;</i></p>

	<p><i>Evidenca I.13.1 Raport vjetor i Njesisë Bazë të Gjuhëve të Huaja 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca I.13.2 Raport vjetor i Njesisë Bazë të Gjuhëve të Huaja 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca I.13.3 Raport vjetor i Njesisë Bazë të Gjuhëve të Huaja 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstatoi se UGJ zhvillon takime informuese dhe trajnuese me qëllim vlerësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze. NJSBC, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, dhe Njësitë Kryesore organizojnë Workshop-e. Këto organizime kanë për qëllim përmirësimin e kurrikulave dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës. Lidhur me programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze këto aktivitete u vijnë në ndihmë studentëve për të gjetur hapsira punësimi në profile të ndryshme. Gjithashtu, nëpërmjet ndarjes së eksperiencave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni-t studentët rrisin motivimin jo vetëm për ndjekjen e programit të studimit edhe në nivele të tjera por edhe motivimin për tu bërë shumë shpejt pjesë e tregut të punës sipas profileve të kërkuara, mbështetur në aftësitë e secilit student. Si bashkëpunëtor dhe ekspertë të jashtëm të ftuar në këto tryeza janë përfaqësues të bizneseve, institucioneve publike e private, në statusin e punëmarrësve kryesorë të studentëve të UGJ-së. Mbështetur në takimin e zhvilluar në UGJ, rezultoi se shpeshherë janë vetë bizneset të cilët u drejtohen universitetit për tu ofruar studentëve mundësi praktike (e paguar ose e papaguar) ose pune sezonale.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca VI.7.1 Organizimi i pyetësorit studentor për cilesinë e mësimdhënies në UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca VI.2 Procedura për zhvillimin me sukses të Sondazhit Kombëtar të studentëve;</i></p> <p><i>Evidenca II.19 Databaze Alumni; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE. Tabela 23. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve;</i></p> <p><i>Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2023.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konstaton se, edhe pse UGJ ka ngritur struktura</i></p>

<p>dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>instrumentat e vlerësimit, duhet të përdoret në fund të çdo viti akademik nga ana e strukturave përgjegjëse.</p> <p>GVJ edhe pse e konsideron si një praktikë të mirë, raportet vjetore të njësive apo zyrave, ato i përgjigjen më së shumti të dhënave për ecurinë e objektivave të vendosura nga njësia kryesore dhe njësia bazë dhe më pak të dhënave për përmirësimin e cilësisë dhe ecurinë e këtij përmirësimi.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca VI.3 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca VI.3.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca VI.3.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Lidhur me këtë kriter, GVJ konstatoi se vlerësimi i cilësisë së programit Bachelor në Gjuhë Angleze sigurohet nëpërmjet cilësisë si edhe numrit të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, cilësisë së materialeve mësimore dhe infrastrukturës. Megjithatë, këto elementë nuk janë të mjaftueshëm për të garantuar një mësimdhënie dhe shërbim cilësor. Vlerësimi didaktik i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve dhe vëzhgimeve në klasë duhet të shoqërohet me raporte të cilat u bëhen të njohura personelit akademik në kuadër të përmirësimit të performancës. Edhe pse në raporte departamenti shprehet se janë realizuar vëzhgime në auditor, nuk rezulton një analizë e mirëfilltë i vëzhgimit i cili përmbledhet me rezultate të matshme dhe konkrete. Për sa më sipër, GVJ vëren se duhet të përmirësohen mekanizmat dhe instrumentat matës të sigurimit të cilësisë dhe të bëhen sa më efektivë duke iu përshtatur ndryshimeve dhe programit të studimit për të garantuar cilësinë e standardeve.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca I.11.6 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022;</i></p>
	<p><i>Evidenca I.12 Raporti vjetor Njësia Kryesore FESHSH 2018-2019 ; Evidenca I.12.4 Raporti vjetor Njësia Kryesore FESHSH 2020-2021; Evidenca I.12.6 Raporti vjetor Njësia Kryesore FESHSH 2021-2022;</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara në UGJ dhe mbështetur në dokumentacionin e marrë në shqyrtim, GVJ konstatoi se universiteti, njësia kryesore dhe njësia bazë hartojnë raporte të përvitshme, pjesë e të cilëve janë edhe analizat e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Gjithashtu, përfaqësuesi i njësië bazë konfirmoi se në programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze janë bërë ndryshime sa herë është konsideruar e nevojshme. Megjithatë, edhe në raportet sipas evidencave më poshtë mungojnë mekanizmat dhe instrumentat matës të cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë institucionale. Këto instrumenta dhe mekanizma janë shumë të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së UGJ mbështetur edhe në standardet ligjore në fuqi. Edhe pse njësia ka bërë ndryshime të programeve të studimit mbështetur në problematikat e evidentuara nga departamenti në tërësi, nuk ka përdorur mekanizma konkret matës.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca VI.7.1 Organizimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca VI.2 Procedura për zhvillimin me sukses të Sondazhit Kombëtar të studentëve;</i></p> <p><i>Evidenca VI.7.2 Analiza e pyetësorit për procesin e mësimin online.</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive</p>	<p>GVJ vëren se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë duhet të realizojë vlerësimet dhe matjen performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë tu vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive në dosjet e personelit pranë Zyrës së Burimeve Njërezore. Informacioni i gjeneruar nga</p>

	<p><i>Evidenca I.21.1 Plani i veprimit pas rekomandimeve të Bordit të Akreditimit;</i></p> <p><i>Evidenca I.21.2 Vendim SA për miratimin e planit të veprimit;</i></p> <p><i>Evidenca VI.2 Procedura për zhvillimin me sukses të Sondazhit Kombëtar të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Pas takimeve të zhvilluara në UGJ si edhe shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga i njeiti universitet, GVJ konstatoi se njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të ketë një plan pune me të qartë në lidhje me mbarëvajtjen e aktivitetit të saj, për matjen e cilësisë. Edhe njësia bazë duhet të bashkëpunojë me NJBSC dhe sëbashku të procedojnë me monitorime që i shërbejnë ruajtjes së standardeve dhe cilësisë. Monitorimet duhet të kenë si qëllim përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies, respektimin e formateve të programeve të lëndëve dhe shumë formateve të tjera që janë në shërbim të procesit mësimor. Edhe pse në raportet e shkruara nga NJSBC shkruhet se monitorimet janë realizuar, mungojnë instrumentat matës të cilët vërtetojnë realizimin e monitorimit, mënyrën e monitorimit dhe rezultatet e matshme të monitorimit.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 94, pika 5;</i></p> <p><i>Evidenca VI.7.1 Organizimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca VI.7.2 Analiza e pyetësorit për procesin e mësimit online;</i></p> <p><i>Evidenca VI.3 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca VI.3.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca VI.3.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se standardi plotësohet kryesisht. <u>GVJ sugjeroi se NJBSC dhe Njësia Bazë të bashkëpunojnë për monitorimin e procesit të mësimdhënies, të hartohen më shumë pyetësore dhe të përdoren mekanizma të ndryshëm për monitorimin dhe vlerësimin jo vetëm të mësimdhënies por edhe të kërkimit shkencor, si edhe të shtohet bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm për të ndihmuar në këtë proces.</u></i></p>

	<p><i>Evidenca VI.3 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca VI.3.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca VI.3.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave, Njësia Kryesore dhe Njësia Bazë, përbëjnë sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë në UGJ. Megjithatë, ky sistem duhet të zbatohet një strategji institucionale të mirëfilltë për përmirësimin e cilësisë dhe duhet të bashkëpunojë me aktorë të ndryshëm, përfshirë studentë apo ekspertë të jashtëm për garantimin e cilësisë. Mbështetur në takimet e zhvilluara në UGJ si edhe në dokumentat e vënë në dispozicion nga UGJ, <i>GVJ konstatoi se specifikisht për programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze, UGJ duhet të rrisë bashkëpunimin me ekspertët e jashtëm, si elementë ndihmës në procesin e garantimit të cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi.</i></p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025;</i></p> <p><i>Evidenca VI.4, Rregullore e NJSCB, neni 4;</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 96, pika 2;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit në UGJ, GVJ vërenjti se në bashkëpunim me ASCAL, UGJ realizon edhe sigurimin e jashtëm të cilësisë. Afatet dhe procedurat e akreditimit janë të parashikuara në rregulloren e njësive së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UGJ. UGJ-ja ka marrë akreditimet periodike institucionale, me Vendim Nr.67, datë 21.09.2017 dhe Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL. Gjithashtu në vitin 2019 dhe 2022 UGJ i është nënshtruar vlerësimit edhe nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve, realizuar nga ASCAL.</p> <p>Evidenca</p> <p>https://uogj.edu.al/vendim-i-ba-dhe-crtifikata-e-akreditimit/;</p> <p><i>Evidenca I.21 Vendim i Akreditimit Institucional periodik;</i></p>



nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë. Puna e NJSBC-së duhet të realizohet bazuar në një planifikim vjetor, i cili i përgjigjet edhe politikave të institucionit, parashikuar në stautin e tij (misioni dhe vizioni). Gjithashtu plani vjetor i punës asiston jo vetëm NJSBC-në, por të gjitha strukturat e UGJ, për të realizuar takime informuese, aktivitete ndërgjegjësuese dhe advokim për pjesëmarrje aktive në sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Në raportet e NJSBC sipas edhe evidencave (raportet vjetore), rezulton se në zhvillimin e procesit mësimor janë vërenjtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, seminareve apo seancave laboratorike por këto përfundime nuk janë lehtësisht të matshme. Kjo pasi edhe në evidenca por edhe në raporte mungojnë instrumentet e përdorura për matjen e cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu, mungesa e pyetësorëve nuk e bën të matshëm përfundimin nëse këto metoda të përdorura kanë rezultuar të efektshme apo jo. Pavarisht ngritjes së NJSBC ende nuk është realizuar një pyetësor mbi vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies apo vlerësm institucional nga ana e studentëve. Edhe pse vetë njësia deklaron nëpërmjet raporteve se procesi i mësimdhënies është në përputhje me standardet e sigurimit të cilësisë, nuk ka instrumente të cilat e vlerësojnë objektivisht procesin.

Evidenca

Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025;

Evidenca VI.4 Rregullore e NJSBC, neni 3, 5, 6, 7;

Evidenca VI.4.2 Anëtarët e NJSBC;

Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 94;

Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 93;

Evidenca VI.7.1 Organizimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në UGJ;

Evidenca VI.7.2 Analiza e pyetësorit për procesin e mësimin online; Raport i analizës së pyetësorëve;

	<p><i>Evidenca I.12 Raporti vjetor Njësia Kryesore FESHSH 2018-2019 ; Evidenca I.12.4 Raporti vjetor Njësia Kryesore FESHSH 2020-2021; Evidenca I.12.6 Raporti vjetor Njësia Kryesore FESHSH 2021-2022; Evidenca I.13.1 Raport vjetor i Njësise Baze të Gjuhëve të Huaja 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca I.13.2 Raport vjetor i Njesisë Bazë të Gjuhëve të Huaja 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca I.13.3 Raport vjetor i Njesisë Bazë të Gjuhëve të Huaja 2021-2022.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ gjatë takimeve të zhvilluara në UGJ dhe shqyrtimit të dokumentacionit, konstatoi se institucioni ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies</i></p> <p><i>UGJ ka ngritur struktura të posaçme të cilat kanë si funksion të tyre monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, por ky proces nuk realizohet në mënyrë periodike dhe sipas instrumentave të institucionalizuara. Për pasojë, GVJ konstaton se bëhet e pamundur matja dhe vlerësimi periodik i cilësisë apo evidentimi dhe promovimi i praktikave më të mira.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ sugjeron zhvillimin periodik të pyetësorëve të cilët monitorojnë procesin e mësimdhënies. Gjithashtu, GVJ sugjeron përdorimin e mekanizmave të ndryshëm për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Për sa më lart, GVJ vlerëson se ky standard plotësohet kryesisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e	Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 si edhe në statutin e UGJ, Senati Akademik ka miratuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) si strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ,

	<p><i>Evidenca VI.3 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca VI.3.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca VI.3.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ pas takimeve të zhvilluara në institucion, konstaton se edhe pse janë ngritur struktura të posaçme me funksione të dedikuara për hartimin e mekanizmave të vlerësimit, ato nuk aplikohen në mënyrë periodike. Ky proces i realizuar në këtë mënyrë, ndikon në mos prodhimin periodik të rezultateve të vlerësimit e për pasojë, krijon vështirësi në promovimin e praktikave më të mira apo nxitjen e përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>GVJ vlereson si një praktikë të mirë periodicitetin e raporteve vjetore institucionale dhe të njësisë bazë, të cilat përmbajnë ndër të tjera edhe elementë që lidhen me mësimdhënien apo këkrimin shkencor, por në këto raporte mungon pasqyrimi i vlerësimit të studentëve apo promovimi i praktikave më të mira. Këto raporte vjetore, përveçse janë një detyrim ligjor, i përgjigjen vetëm pasqyrimin të procesit akademik vjetor dhe nuk zëvendësojnë instrumentat e matjes së cilësisë.</p> <p>Mbështetur në takimet e zhvilluara me personelin akademik, studentët dhe përfaqësuesit e njësisë së sigurimit të cilësisë në UGJ, GVJ konstatoi se ky institucion si edhe Njësia bazë dhe Njësia Kryesore duhet të punojnë më shumë në krijimin e mekanizmave të reja të vlerësimit të procesit të mësimdhënies në mënyrë që të arrihet një përmirësim i dukshëm i procesit të mësimdhënies. Gjithashtu, në të njëjtën mënyrë duhet punuar edhe në përdorimin e mekanizmave vlerësues të punës kërkimore shkencore të personelit akademik, zhvillimit të kapaciteteve didaktike dhe kërkimore si edhe përdorimin e platformave teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies. Edhe për vlerësimin e punës kërkimore shkencore rezultoi një mangësi në përdorimin e mekanizmave vlerësues.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca I.11.6 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022;</i></p>

	<p>së studentit për ankimimin e rezultatit të vlerësimit të dijes sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e studimeve në UGJ. Vlerësimi i formave të metodave të mësimdhënies është realizuar vetëm gjatë periudhës së pandemisë nëpërmjet një pyetëtori ku studentët kanë vlerësuar metodat e mësimdhënies dhe performancën akademike të mësimit online. Në vitet pasardhëse nuk figuron të jenë aplikuar pyetësorë në mënyrë periodike për vlerësimin e procesit të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 88, gërma h, neni 91, pika 5;</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 88, pika 1 gërma b;</i></p> <p><i>Evidenca V.10 Vendimi për ngritjen e GVB të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze;</i></p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e UGJ, Neni 88.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Lidhur me këtë kriter, mbështetur në evidencat e dorëzuara nga UGJ, GVJ konstatoi se në statutin e këtij universiteti parashikohen nene specifike për detyrimin e UGJ për të hartuar dhe publikuar rezultatet e vlerësimit duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, së bashku me rekomandimet përkatëse. Bazuar në takimet e zhvilluara në UGJ, GVJ konstatoi se pyetësorët e realizuar për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies janë të paktë (vetëm pyetëtori i realizuar gjatë pandemisë) dhe nuk janë periodikë. Sikurse është deklaruar edhe gjatë takimeve, ky kriter realizohet nëpërmjet diskutimeve mes personelit akademik dhe studentit në fund të orës mësimore, feedback ky jo lehtësisht i matshëm dhe i besueshëm. Ndaj, Njësia e Sigurimit të Cilësisë duhet të realizojë më shumë pyetësorë për monitorimin e procesit të mësimdhënies dhe cilësisë së tij, duke i paraqitur rezultatet në formën e raporteve. Gjithashtu, personeli akademik duhet të njihet me rezultatet e pyetësorit dhe të reflektojë në përmirësim të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 94, pika 5, gërma h;</i></p> <p><i>Evidenca VI.7.2 Analiza e pyetësorit për procesin e mësimit online</i></p> <p>https://uogj.edu.al/transparencat/</p>

	<p>inovative të personelit, nuk është aplikuar në vitët pasardhëse akademike. Gjithashtu gjatë vizitës në institucion dhe gjatë takimit me NJSBC, nuk u prezantua një instrument i institucionalizuar për realizimin periodik të këtij procesi.</p> <p>Procesi i monitorimit dhe vlerësimit, referuar edhe takimeve me studentët dhe personeli akademik u theksua bashkëpunimi me njëri tjetrin në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, duke diskutuar vazhdimisht dhe në fund të orës së mësimi rreth çështjeve të cilat lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Edhe pse GVJ e konsideron këtë proces si një praktikë shumë të mirë, këto diskutime nuk mund të konsiderohen instrumenta matës sipas akteve ligjore në fuqi dhe për më tepër nuk konsiderohen periodikë sikurse kërkohet.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 93, 94 pika 5;</i></p> <p><i>Evidenca VI.1 Manuali i Cilësisë në UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca VI.1.1 Vendim Senati për miratimin e Manualit të Cilësisë në UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca VI.7.1 Organizimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca VI.7.2 Analiza e pyetësorit për procesin e mësimi online; Evidenca I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020;</i></p> <p>https://uogj.edu.al/kodi-cilesise/</p> <p><i>Evidenca VI.4 Rregullore e NJSBC, neni 3;</i></p> <p><i>Evidenca VI.4.2 Anëtarët e NJSBC;</i></p> <p><i>Evidenca VI.4.1 Vendim i SA për ngritjen e NJSBC.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në statutin e UGJ parashikohet përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve. Sipas statutit, kjo përfshirje arrihet nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në procesin e anketimit për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet në nivel institucional dhe gjithashtu në organe në nivel njësic kryesore. Gjithashtu, kjo përfshirje realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, garantimit të së drejtës</p>



	<p>një klasë apo të bëhen pjesë e klasës, si të bëhet shtimi i studentëve ose sesi studenti mund të bëhet anëtar i kalsës. Teknikalitetet e tjera mbi këtë manual lidhen me mënyrën e komunikimit, shpërndarjen e njoftimeve dhe lajmërimeve, krijim e detyrave, korigjimin e detyrave, etj. Gjatë kësaj periudhe personeli i IT-së së universitetit ka qëndruar në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik për ti ndihmuar qoftë me udhëzues qoftë me ndihmë teknike për përdorimin e platformave teknologjike, është deklaruar gjatë takimeve në UGJ.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies;</i></p> <p><i>Evidenca III.1 Urdhër për platformën e mësimi online;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimi online Classroom;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimi online Edumeet;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online Office365;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik;</i></p> <p><i>Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët;</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni, referuar akteve ligjore e nënligjore në fuqi si dhe akteve të brendshme, ka ngritur në nivel institucioni Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si një strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Gjatë vitit 2022, UGJ ka organizuar një pyetësor për studentët me qëllim verifikimin e cilësisë së mësimdhënies gjatë periudhës së pandemisë, kur mësimi u zhvillua online. NJSBC, si strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, gjatë takimeve në UGJ deklaroi se pyetësori i zhvilluar gjatë vitit 2022 lidhej specifikisht me kontrollin e cilësisë së mësimdhënies gjatë periudhës së pandemisë. Pyetësori i zhvilluar iu përgjigj situatës jo normale të zhvillimit të procesit mësimor. GVJ konstaton se procedura e monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësimeve mësimdhënëse dhe</p>

autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gjirokastër për shkak të rritjes së numrit të turistëve të huaj që vizitojnë këtë qytet pothuajse gjatë të gjithë vitit”, u shprehën përfaqësuesit e UGJ në takim.			
	<p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca V.13 Formular gjurmimi të studentëve;</i></p> <p><i>Evidenca V.13.1 Korrespondenca për Këshillimin e karrierës;</i></p> <p><i>Evidenca V.13.2 Plani vjetor i punës për Këshillimin e karrierës; Evidenca II.19 Databazë Alumni;</i></p>			
Konkluzione	GVJ gjatë takimeve me grupet e studentëve dhe përfaqësuesve të zyrës së këshillimit të karrierës vuri re një impenjim të UGJ për ti ndihmuar studentët të gjejnë veten në tregun e punës dhe duke i orjentuar ato drejt mundësive të punësimit, si në sektorin publik edhe në atë privat.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstatoi se UGJ ka hartuar një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në nivel institucional, që është edhe në funksion të programit Bachelor në Gjuhë Angleze. Ky udhëzues e prezanton personelin akademik me metoda të reja dhe inovative të mësimdhënies. Gjatë takimeve që zhvilloi GVJ në UGJ, u theksua përdorimi i platformave online gjatë periudhës së pandemisë. Konstatohet se UGJ ka vënë në dispozicion manualin e përdorimit të platformës TEAMS ku personeli akademik dhe studentët të njihen me mënyrën sesi të hapin

<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në takimin me studentët në UGJ, GVJ vuri re se njësia bazë jep një ndihmë shumë të madhe në asistimin e studentëve për problematika të ndryshme që mund të hasin gjatë vitit akademik. Gjithashtu, në ditët e para të regjistrimit, studentët asistohen nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumnit dhe njësia bazë. Studentët u shprehën se gjatë gjithë vitit komunikimi me sekretarinë mësimore dhe personelin akademik është i pandërprerë dhe se këto struktura janë të gatshme të informojnë studentët apo orientojnë ato lidhur me kërkesat që mund të kenë. Përveç komunikimit të drejtëpërdrejtë në zyrë, studentët mund të mbajnë edhe komunikimin me email apo të informohen për çdo informacion në rrjetët sociale të vëna në dispozicion të tyre.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Udhërrëfyes për studentët;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në vizitën e realizuar në UGJ si edhe në takimet me studentët, GVJ konstatoi se studentët e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze informohen periodikisht për mundësi trajnimi, intershipi, praktike profesionale nga institucione dhe kompani private me të cilat UGJ ka marrëveshje bashkëpunimi. Këto aktivitete ekstrakurrikulare ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale. Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar janë strukturat të cilat shërbejnë si urë lidhëse mes studentëve dhe palëve të treta, sikurse parashikohet edhe në statutin e universitetit dhe rregulloren e njësisë bazë.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 42;</i></p> <p><i>Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 14.</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e</p>	<p>Pas diplomimit, UGJ mban komunikimin me studentët dhe në këtë mënyrë plotëson një databazë mbi punësimin e studentëve dhe evidentimin nëse ata janë punësuar në profilin në të cilën kanë përfunduar studimet. Nga takimet e realizuara në UGJ me studentë dhe përfaqësues të zyrës së këshillimit të karrierës, rezultoi se pjesa më e madhe e studentëve të diplomuar në programin Bachelor në Gjuhë Angleze punësohen si mësues, përkthyes ose guidë turistike. Shumë interes kohët e fundit ka marrë roli i guidës turistike në</p>

	<p>së pandemisë është zhvilluar një pyetësorë mbi vlerësimin e mësimin online por pas kësaj NJSBC nuk ka organizuar pyetësorë periodikë mbi vlerësimin e procesit të mësimdhënies. Ky vlerësim duhet të zhvillohet në mënyrë periodike dhe të dhënat e përfituara të paraqiten në formën e një raporti me rekomandimet përkatëse.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi V.6</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga takimi i realizuar në UGJ, GVJ konstatoi se zyrat të cilat vazhdimisht informojnë studentët e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze për programet, kurrikulat, diplomimin, i mbështesin ato në çështje të ndryshme lidhur me procesin mësimor, orjentojnë studentët për mundësitë e studimeve në nivelin e dytë në UGJ ose Universitete të tjera, i këshillojnë ato për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, janë Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës-akademike Administrative dhe Sektori i Shërbimeve Bibliotekare Arkivore dhe Studentore, Zyra e Alumnit dhe e Këshillimit të Karrierës. Gjithashtu, informimi i studentëve realizohet edhe nëpërmjet Sekretarive mësimore, Zyrës së IT-së, Dejtorisë së Shërbimeve Universitare, Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ku studenti merr asistencën e nevojshme në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike diplomimin, detyrimet dhe shërbimet financiare, pjesmarrje në mobilitete.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 42; Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 14;</i></p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Nenet 42, 43, 44;</i></p>

	<p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër Çabej, Neni 88, gërma h, Neni 91, pika 5;</i></p> <p><i>Evidenca VI.7.1 Organizimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në UGJ;</i></p> <p><i>Evidenca VI.7.2 Analiza e pyetësorit për procesin e mësimin online.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ u njoh gjatë vizitës në UGJ edhe me procedurën që ky universitet ndjek në rast se studenti i programit të studimit Bachelor në Gjuhë Angleze nuk është i kënaqur me vlerësimin në një lëndë të caktuar. Konkretisht, studenti duhet të bëjë një kërkesë me shkrim të cilin ia drejton Dekanit të fakultetit dhe ky i fundit përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo në mënyrë që të marrë vendimin përkatës. Nëse ka raste që vërtetohen praktika që bien ndesh me rregulloren e njesisë kryesore dhe njesisë bazë, Dekani me propozim të Përgjegjësit të Departamentit vendos për ndryshimin e komisionit të provimit i cili është ngritur për vlerësimin e provimit dhe ofrimin e mundësisë së rihënies së provimit.</p> <p>Evidenca</p> <p><i>Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VII;</i></p> <p><i>Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave shoqërore, Kreu VIII;</i></p> <p><i>Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, neni 21; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu V;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 46;</i></p> <p><i>Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 46, pika 2.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UGJ ka të përfshirë dhe i angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Mbështetur në evidencat e vëna në dispozicion rezulton se studentët janë të përfaqësuar me anëtarë të komisioneve zgjedhore institucionale, organizohen në këshilla studentorë dhe janë anëtarë të GVB për akreditim. Studentët kontribuojnë në përmirësimin e programit të studimit nëpërmjet shprehjes së vlerësimit të tyre kryesisht gjatë komunikimit të drejtëpërdrejtë me drejtuesin e departamentit ose vetë personelin akademik. Gjatë periudhës</i></p>